

**Donika AVDULLI**

Instituti i Historisë “Ali Hadri”

Email: d.avdulli@uw.edu.pl

ORCID: 0009-0006-9400-7191

KUD: 327(496.5:438)“1949/1951”(05)

**MARRËDHËNIET KULTURORE SHQIPËRI – POLONI  
(1949 - 1951) SIPAS DOKUMENTEVE DIPLOMATIKE  
SHQIPTARE DHE POLAKE****Abstrakt:**

*Ky punim trajton marrëdhëniet kulturore ndërmjet Shqipërisë dhe Polonisë gjatë viteve 1949 - 1951, të periudhës kur misionet diplomatike u drejtuan nga Mihal Prifti dhe Boleslaw Jeleń. Duke u mbështetur në dokumente arkivore, studimi synon të zërthejë jo vetëm dimensionin protokollar dhe institucional të këtyre marrëdhënieve, por edhe funksionin e tyre kulturor si një pjesë integrale e strategjisë së kampit socialist në pasluftë. Emërimet e diplomatëve përbënin një pikënisje thelbësore, ku biografitë politike dhe partizane të përfaqësuesve si Prifti dhe Jeleń i jepnin legjitimitet dhe autoritet marrëdhënieve të reja bilaterale. Analiza tregon se proceset e akreditimit diplomatik, ceremonitë e pritjes dhe përfshirja e elementëve shoqërorë si studentët shqiptarë në Poloni, përveç se ishin akte protokollare, funksiononin si instrumente propagandistike për të theksuar miqësinë brenda bllokut lindor. Struktura e legatës shqiptare në Varshavë, e përbërë nga figura me profile të ndryshme politike, ekonomike dhe administrative, pasqyronte një vizion të koordinuar për bashkëpunim shumëplanësh. Në të njëjtën kohë, prania e stafit mbështetës polak në legatën shqiptare shënon një ndërlidhje të ngushtë kulturore dhe funksionale. Nga ana tjetër, veprimtaritë kulturore të vitit 1949, si ftesat për pjesëmarrje në kongrese letrare, manifestime përkujtimore dhe gara sportive ndërkombëtare dëshmojnë për përpjekjet reciproke për të ndërtuar ura komunikimi përtej marrëdhënieve politike. Edhe pse në raste të caktuara pala shqiptare shfaqej e rezervuar në pjesëmarrje, vetë procesi i shkëmbimit të ftesave dhe i përfaqësimit institucional kontribuonte në krijimin e një hapësire të përbashkët të kulturës socialiste. Përfshirja e organizatave punëtore, shkrimtarëve dhe sportistëve në këto iniciativa, nxjerr*

*në pah karakterin e politizuar të kulturës në epokën staliniste, ku arti, sporti dhe kujtesa historike shërbenin si instrumente të diplomacisë popullore. Në përfundim, marrëdhëniet shqiptaro - polake të viteve 1949 - 1951, të ndërmjetësuar nga diplomatët Prifti dhe Jeleń, përfaqësojnë një model tipik të ndërthurjes së diplomacisë shtetërore me diplomacinë kulturore, duke dëshmuar se politika e jashtme e vendeve të kampit socialist nuk kufizohej vetëm në shkëmbime formale diplomatike, por synonte të krijonte një integrim ideologjik dhe kulturor të gjerë. Dokumentet arkivore ofrojnë një pasqyrë të qartë të këtij procesi, duke e vendosur rastin shqiptar në kuadrin më të gjerë të marrëdhënieve të Lindjes së Evropës gjatë Luftës së Ftohtë.*

**Fjalë kyçe:** Marrëdhënie, diplomaci, bashkëpunim, veprimtari, kulturë, sport, etj.

**Abstract:**

*This paper examines the cultural relations between Albania and Poland during the years 1949-1951, a period when the diplomatic missions were headed by Mihal Prifti and Bolesław Jeleń. Based on archival documents, the study aims to analyze not only the protocol and institutional dimensions of these relations but also their cultural function as an integral part of the postwar socialist bloc's strategy. The appointments of diplomats constituted a crucial starting point, where the political and partisan biographies of representatives such as Prifti and Jeleń provided legitimacy and authority to the new bilateral relations. The analysis shows that diplomatic accreditation processes, reception ceremonies, and the involvement of social elements, such as Albanian students in Poland, besides being protocol acts, functioned as propagandistic instruments to emphasize friendship within the Eastern bloc. The structure of the Albanian legation in Warsaw, composed of figures with diverse political, economic, and administrative profiles, reflected a coordinated vision for multidimensional cooperation. At the same time, the presence of supporting Polish staff in the Albanian legation marked a close cultural and functional interconnection. On the other hand, the cultural activities of 1949, such as invitations to participate in literary congresses, commemorative events, and international sports competitions, reflect reciprocal efforts to build channels of communication beyond political relations. Although the Albanian side was occasionally reserved in participation, the very process of exchanging*

*invitations and institutional representation contributed to creating a shared space for socialist culture. The involvement of workers' organizations, writers, and athletes in these initiatives highlights the politicized nature of culture in the Stalinist era, where art, sports, and historical memory served as instruments of popular diplomacy. In conclusion, the Albanian-Polish relations of 1949-1951, mediated by diplomats Prifti and Jeleń, represent a typical model of the intertwining of state diplomacy with cultural diplomacy, demonstrating that the foreign policy of socialist bloc countries was not limited to formal diplomatic exchanges but aimed to create a broad ideological and cultural integration. Archival documents provide a clear overview of this process, situating the Albanian case within the wider context of Eastern European relations during the Cold War.*

**Keywords:** Relations, diplomacy, cooperation, activities, culture, sports, etc.

### **Vendosja e marrëdhënieve diplomatike si pikënisje e shkëmbimeve kulturore shqiptaro – polake**

Konsolidimi i politikës së jashtme të shtetit komunist shqiptar ishte një proces i gjatë dhe jo i lehtë. Pozicionimi politik pro-jugosllav dhe pro-sovjetik i qeverisë së re shqiptare të dalë nga Lufta e Dytë Botërore apriori e nënkuptonte forcimin me prioritet të marrëdhënieve me kampin e shteteve komuniste të Evropës Lindore. Polonia ishte njëra ndër vendet e para të Evropës Lindore më të cilat Republika Popullore (RP) e Shqipërisë vendosi marrëdhënie diplomatike në nivel ambasadorësh. Më 13 janar 1949, Misioni Popullor Shqiptar, në pajtim me udhëzimet e qeverisë së tij, i kishte bërë të ditur zyrtarisht Qeverisë së Polonisë vendimin për forcimin e marrëdhënieve diplomatike ndërmjet dy vendeve. Si pjesë e kësaj nisme, pala shqiptare kishte parashikuar kryerjen e ndryshimeve në përbërjen e personelit të përfaqësimit të saj diplomatike në Poloni.<sup>1</sup>

---

<sup>1</sup> Archiwum Ministerstwa Spraw Zagranicznych (AMSZ), Departament: Protokół Dyplomatyczny z lat 1945–1963, sygn. Z-16 W-3 T-50, Protokół Dyplomatyczny – Poseł Albanii w Moskwie Mihal Prifti proponowany równocześnie na Posła Albanii w Warszawie: Listy uwierzytelniające, korespondencja, notatki, 1949–1951, Daty Skrajne: 1949 – 1951, Państwo: Albania – Ludowa Republika Albanii, Polska – PRL, Region Świata: Europa Południowa, Europa Wschodnia, fl.1.

Qeveria shqiptare i ka kërkuar autoriteteve polake të miratojnë kandidaturën e zotit Mihal Prifti për pozicionin e të Dërguarit të Jashtëzakonshëm dhe Ministër Fuqiptotë të Shqipërisë në Poloni.<sup>2</sup>

Në vijim të komunikimit diplomatik, kërkesa e Ambasadës së Shqipërisë në Varshavë për miratimin e emërimit të Mihal Priftit si përfaqësues zyrtar të Tiranës në Poloni u trajtua nga instancat përkatëse polake sipas procedurave të kohës. Ministria e Punëve të Jashtme të Republikës Popullore të Polonisë vendosi t'ia përcillte këtë çështje Presidentit, duke ndjekur rrugën institucionale të aprovimit të përfaqësuesve të huaj.<sup>3</sup> Vlen të theksohet se akti formal i përcjelljes u shoqërua me nënshkrimin e ambasadorit Stefan Wierbłowski<sup>4</sup>, në cilësinë e sekretarit të Ministrisë,<sup>5</sup> çka tregon për nivelin e lartë të rëndësisë që i atribuohet këtij procesi në hierarkinë diplomatike polake. Ky hap pasqyron jo vetëm respektimin e protokolleve ndërkombëtare të pranimit të diplomatëve, por edhe gatishmërinë e Varshavës për të ruajtur marrëdhënie të rregullta institucionale me Tiranën në këtë fazë të pasluftës.

<sup>2</sup> Një biografi e detajuar e tij ishte bashkëngjitur letrës zyrtare. Shë të re, ai u angazhua në lëvizjen çlirimtare dhe nga viti 1943 luftoi në radhët partizane. Në vitin 1945, mori detyrën e Sekretarit të Përgjithshëm të Presidiumit të Këshillit të Ministrave të Mihal Prifti, i lindur në Gjirokastrë më 1918, ndoqi studimet në Athinë dhe Romë. Qysh në moshë Shqipërisë. Në prill të vitit 1947, ai u emërua i Dërguari i Jashtëzakonshëm dhe Ministër Fuqiptotë i Shqipërisë në Moskë, Po aty, fl.3-4.

<sup>3</sup> Po aty, fl.6.

<sup>4</sup> Stefan Wierbłowski ishte politikan, diplomat dhe publicist polak, figurë e spikatur e lëvizjes komuniste. Anëtar i Komsomolit (1919) dhe i Partisë Komuniste të Punëtorëve Polakë (1920), ai mbajti funksione drejtuese, përfshirë sekretar i Komitetit të Qarkut të Pragës dhe i Sekretariatit Kombëtar të KQ të KPP-së. Pas studimeve në Poloni dhe Francë, u arrestua (1935) për veprimtari komuniste dhe u lirua pas pushtimit gjermano-sovjetik. Gjatë Luftës së Dytë Botërore punoi në Komintern dhe në Byro Qendrore të Komunistëve të Polonisë në Moskë. Në vitin 1944 u kthye në Poloni si anëtar i KQ të Partisë Punëtorë Polake, duke shërbyer si zëvendëskryetar dhe nënsekretar shteti në Ministrinë e Informacionit dhe Propagandës. Ambasador në Çekosllovakia (1945–1947), më pas Sekretar i Përgjithshëm dhe Nënsekretar Shteti në MPJ. Pas vitit 1954 drejtoi institucione akademike dhe shkencore, ishte sekretar i Byrosë Politike për çështjet e shkencës dhe përfaqësues i Polonisë në UNESCO, ku u bë zëvendëskryetar i Këshillit Ekzekutiv (1962). Kryeredaktor i *Nowe Drogi* (revistë mujore ideologjike polake, “organ teorik dhe politik” i Komitetit Qendror të PZPR-së (më herët i KQ të PPR-së), e botuar në Varshavë në vitet 1947–1989 nga “RSW Prasa-Książka-Ruch”), anëtar i KQ të PZPR (1948–1968). Vdiq në Varshavë, i varrosur në Varrezat Ushtarake të Powązkave.

<sup>5</sup> AMSZ, Dep. Protokół Dyplomatyczny z lat 1945-1963, sygn. Z-16 W-3 T-50, Protokół Dyplomatyczny – Posel Albanii..., dok.i.cit, fl.6.

Më 3 shkurt 1949, pas një kërkesë të ardhur nga Kryeministri, Stefan Wierbłowski mori konfirmimin zyrtar se kandidatura e Mihal Priftit për detyrën e të Dërguarit të Jashtëzakonshëm dhe Ministrit Fuqiptotë të Shqipërisë në Varshavë nuk haste në kundërshtime nga pala polake. Ky zhvillim interpretohet si një shenjë e qartë e vullnetit politik të qeverisë së Republikës Popullore të Polonisë për të thelluar marrëdhëniet diplomatike me Shqipërinë. Vetëm pak ditë më vonë, më 12 shkurt 1949, në Tiranë, Presidiumi i Kuvendit Popullor i drejtoi Presidentit të Republikës Popullore të Polonisë, Bolesław Bierut, një kërkesë zyrtare për miratimin e emërimit të Priftit, duke institucionalizuar kështu hapin e ndërmarrë në kuadër të diplomacisë dypalëshe, një kërkesë që u miratua nga pala polake.<sup>6</sup>

Mbërritja e Mihal Priftit në Varshavë në prill 1949, pas një udhëtimi nga Moska, ilustron mënyrën sesi marrëdhëniet diplomatike shqiptaro-polake në fund të viteve '40 zhvilloheshin brenda kornizës së bllokut lindor dhe nën ndikimin e drejtpërdrejtë sovjetik. Pritja e tij në aeroport nga Llambi Dishnica, sekretar i Legatës Shqiptare, atasheu tregtar Angoni Murat dhe një grup studentësh shqiptarë, kishte jo vetëm funksion ceremonial, por edhe propagandistik, duke theksuar praninë e komunitetit shqiptar në Poloni si element të afrimit politik e shoqëror. Akomodimi në Hotel Bristol dhe vizita e planifikuar te Drejtori i Protokollit Diplomatik nënvizojnë respektimin e standardeve të larta protokollare dhe seriozitetin e marrëdhënieve dypalëshe.<sup>7</sup> Prifti kishte tashmë një histori kontakti me Poloninë, përmes pjesëmarrjes në Kongresin e Wrocławit dhe Kongresin e Bashkimit, që e vendoste atë në pozitë të favorshme për të zhvilluar bisedime të drejtpërdrejta me diplomatë dhe ministra polakë. Profili i anëtarëve të legatës, si Dishnica me përvojë partizane dhe diplomatike, dhe Murat me funksion ekonomik, tregon qartë se misioni shqiptar synonte të mbulonte një gamë të gjerë bashkëpunimi - nga politika te ekonomia - në përputhje me strategjinë e koordinuar të kampit socialist.<sup>8</sup>

Në gusht 1949, autoritetet polake morën vendimin për të caktuar Bolesław Jeleń në detyrën e Këshilltarit të Legatës në Tiranë. Ky hap synonte thellimin e marrëdhënieve miqësore mes dy vendeve. Si person përgjegjës për punët e

<sup>6</sup> Po aty, fl.7-8.

<sup>7</sup> AMSZ, Departament: Departament I za lata 1949 – 1960 (państwa socjalistyczne bez NRD), sygn. Z-7 W-17 T-148, Notatki z rozmów prowadzonych przez polskich dyplomatów z dyplomatami albańskimi akredytowanymi w Warszawie, Daty Skrajne: 1949-1958, Państwo: Albania, Polska – PRL, Region Świata: Bałkany, Europa Środkowa, fl.2-4.

<sup>8</sup> Po aty, fl.2-4.

përfaqësisë, Jeleń mori përsipër drejtimin e Legatës së Polonisë dhe mbrojtjen e interesave të Republikës Polake në kryeqytetin e Shqipërisë.<sup>9</sup> Nga data 11 deri më 29 gusht 1949, Bolesław Jeleń zhvilloi një sërë takimesh me figura të rëndësishme të jetës politike shqiptare, ndër të cilët ishin Manush Myftiu, Enver Hoxha, Omer Nishani, Bedri Spahiu, Kahreman Ylli dhe Gogo Nushi.<sup>10</sup>

Përmes dokumenteve diplomatike mësojmë strukturën e misionit të parë diplomatik shqiptar në Varshavë:

1. Mihal Prifti, i Dërguar i Jashtëzakonshëm dhe Ministër Fuqiptotë, luante një rol qendror në përfaqësimin e Shqipërisë. Ai ishte përgjegjës për zhvillimin e negociatave diplomatike dhe ruajtjen e marrëdhënieve institucionale me autoritetet polake. Dokumentacioni evidenton periudha të mungesës së tij, të cilat mund të interpretohen si tregues të sfidave operative dhe logjistike të diplomacisë shqiptare në atë periudhë.

2. Znj. Prifti, bashkëshortja e Mihal Priftit, përmendet gjithashtu në dokument, megjithatë mungesa e saj sugjeron se roli i saj brenda misionit mund të ketë qenë i kufizuar ose i përballuar me vështirësi, në përputhje me rrethanat e misionit diplomatik të kohës.

3. Llambi Dishnica, i ngarkuar me punë, kishte përgjegjësinë për menaxhimin e punëve të përditshme të legatës gjatë mungesës së ambasadorit. Ai mbante kontakte të rregullta me Ministrinë e Punëve të Jashtme të Polonisë dhe luante një rol të rëndësishëm në mirëfunksionimin e aktiviteteve diplomatike, veçanërisht në situata krizash.

4. Drita Dishnica, bashkëshortja e Llambi Dishnicës, mund të ketë kontribuar në mënyrë mbështetëse në jetën shoqërore të legatës, një rol që ishte karakteristik për gratë e diplomatëve në atë periudhë, të cilat shpesh ndihmonin në konsolidimin e kontakteve jozyrtare dhe pritjeve diplomatike.

5. Abdyl Ulqinaku, kancelar i legatës, shërbente si sekretar administrativ dhe ishte përgjegjës për funksionimin e përditshëm të misionit diplomatik,

<sup>9</sup> AMSZ, Departament: Protokół Dyplomatyczny z lat 1945 – 1963, sygn. Z – 16 W – 3 T – 46, Protokół Dyplomatyczny – Utworzenie Poselstwa Polski w Tiranie. Bolesław Jeleń Chargé D’Affaires en pied, Listy wprowadzające, korespondencja, Daty Skrajne: 1949 – 1960, Państwo: Albania – Ludowa Republika Albanii, Polska – PRL, Region Świata: Europa Południowa, Europa Wschodnia, fl.1-3.

<sup>10</sup> AMSZ, Departament: Departament I za lata 1949 – 1960 (państwa socjalistyczne bez NRD), sygn. Z – 7, W – 17, T – 147, Notatki z rozmów polskich dyplomatów w Tiranie, Daty Skrajne: 1949 – 1960, Państwo: Albania, Polska – PRL, Region Świata: Bałkany, Europa Środkowa, fl. 2- 10.

duke siguruar vazhdimësinë dhe organizimin e punës administrative.<sup>11</sup>

Në seksionin që ka të bëjë me stafin polak, veçohen disa figura kyçe që siguronin funksionimin e përditshëm të legatës si:

1. Anna Wroblewska-Jacobson, specialiste në gjurmët e gishtërinjve dhe përkthyes, ishte përgjegjëse për dokumentacionin dhe përkthimet, të cilat luanin një rol kyç në sigurimin e komunikimit efektiv me institucionet polake.

2. Antoni Duchnowski, shofer dhe përmbarues, merrej me transportin dhe logjistikën e përditshme të legatës. Megjithatë roli i tij nuk ishte gjithmonë i dukshëm, kontribuonte thelbësisht në funksionimin e efikas të misionit diplomatik.

3. Stefania Stępnjak ishte përgjegjëse për pastrimin, duke siguruar kushte të përshtatshme pune dhe një ambient të rregullt në legatë, element kyç për një mision diplomatik të suksesshëm.<sup>12</sup>

### **Analizë e marrëdhënieve kulturore shqiptaro - polake në vitin 1949**

Gjatë vitit 1949, marrëdhëniet kulturore ndërmjet Shqipërisë dhe Polonisë intensifikoheshin dukshëm. Më 6 janar të atij viti, Ambasada e Polonisë njoftonte se shkrimtarët dhe Ministria e Kulturës polake kishin ftuar një delegat shqiptar të merrte pjesë në Kongresin e Shkrimtarëve në qytetin e Shçëçinit, i cili do të zhvillohej nga 20 deri më 24 janar 1949, ndërsa shpenzimet brenda kufijve polakë do të mbuloheshin nga Polonia. Megjithatë, Lidhja e Shkrimtarëve të Shqipërisë njoftoi se do të dërgonte një letër falënderimi për ftesën, pa dërguar delegat për pjesëmarrje.<sup>13</sup>

Më 14 janar 1949, Aleks Çaçi, në emër të Unionit të Shkrimtarëve, deklaroi: *“Ne e kemi marrë ftesën tuaj për të marrë pjesë në Kongres dhe ju falënderojmë me gjithë zemër. Meqenëse nuk jemi në gjendje të dërgojmë një delegat, ju shprehim urimet tona më të mira dhe shpresojmë sinqerisht që puna e këtij Kongresi të arrijë sukses të madh në fushën e letërsisë së re polake dhe në luftën për lumturinë e popullit polak.”*<sup>14</sup>

<sup>11</sup> AMSZ, Dep. Protokół Dyplomatyczny z lat 1945-1963, sygn. Z-16 W-3 T-50, Protokół Dyplomatyczny – Poseł Albanii..., dok.i.cit, fl.13-14.

<sup>12</sup> Po aty, fl.14.

<sup>13</sup> Arkivi i Ministrisë së Punëve të Jashtme (më tej: AMPJ), V.1949, D.62, fl.1- 4, Shkëmbime me Poloninë në fushat shkencore, shoqërore e sportive.

<sup>14</sup> AMPJ, V.1949, D.62, Shkëmbime me Poloninë..., dok.i.cit, fl.5.

Më 29 janar 1949, nga Varshava, Sekretariati i Përgjithshëm i Shoqatës së Invalidëve të Luftës, me nënshkrimin e A. Kowalskit, i dërgoi Shoqatës së Invalidëve të Luftës Nacionalçlirimtare në Tiranë një ftesë për pjesëmarrje në një manifestim ndërkombëtar që do të mbahej në Hamburg më 8 maj 1949, me rastin e përvjetorit të kapitullimit të Rajhut nazist. Manifestimi, i organizuar nga Këshilli i Shoqatës Gjermane të të Internuarve Politikë, kishte si qëllim nderimin e viktimave të nazizmit dhe inaugurimin e një monumenti me 105 pamje të viktimave nga të gjitha vendet e pushtuara nga Rajhu Nazist. Letra kërkonte konfirmimin e pjesëmarrjes dhe theksonte se duhej njoftuar gjithashtu edhe Sekretariati i Përgjithshëm i F.I.A.P (Fédération Internationale des Anciens Prisonniers politiques – në shqip Federata Ndërkombëtare e Ish-të Burgosurve Politikë).<sup>15</sup>

Më 6 korrik 1949, Legata e Republikës Popullore të Shqipërisë në Varshavë njoftonte se organizata polake *Czytelnik*, e cila korrespondonte me *Ndërmarrjen e Shtypshkronjës, Botimit dhe Shpërndarjes (NSHBSH)*, kishte ftuar një ekip çiklistësh nga *Organizata Punëtore Shqiptare* për të marrë pjesë në një kurs, i cili do të zhvillohej nga 22 gushti deri më 4 shtator 1949. Shkresa përkatëse u dërgua nga i ngarkuari me punë në legatë, *Llambi Dishnica*, duke shërbyer si kanal komunikimi midis autoriteteve shqiptare dhe organizatës polake.<sup>16</sup>

Kjo garë, e njohur si edicioni i VIII-të i “Tour de Pologne”, u mbështet nga Fondacioni Polak i Çiklizmit dhe mblodhi ekipe punëtorësh çiklistë nga disa vende. Çdo skuadër kishte të drejtë të paraqiste tetë sportistë, shoqëruar nga staf teknik e ndihmës, ndërsa renditja ekipore përcaktohej nga koha e tre çiklistëve të parë.

Organizatorët mbuluan shpenzimet e udhëtimit vajtje-ardhje me avion ose tren, akomodimin dhe furnizimet, jo vetëm gjatë kohës së garës, por edhe tre ditë para dhe tre ditë pas saj.<sup>17</sup> Gjithashtu ofroheshin shërbime mjekësore, asistencë teknike dhe lehtësira të tjera për të gjithë pjesëmarrësit. Në garën ekipore, çmimi kryesor ishte Çmimi i Nderit i Presidentit të Kooperativës *Czytelnik*, ndërsa në garën individuale shpërndaheshin 500 çmime me një vlerë totale prej rreth pesë milionë zlotësh.<sup>18</sup>

<sup>15</sup> Po aty, fl.6.

<sup>16</sup> Po aty, fl.8.

<sup>17</sup> Po aty, fl.9.

<sup>18</sup> AMPJ, V.1949, D.62, Shkëmbime me Poloninë..., dok.i.cit, fl.9.

Nisja dhe përfundimi i garës u zhvilluan në Varshavë, ndërsa itinerari përfshinte disa etapa në qytete të ndryshme të Polonisë, të cilat paraqiten më poshtë:

<i>Data</i>	<i>Etapa</i>	<i>Rruga</i>	<i>Km</i>
22 gusht	Etapa I	Varshavë - Lodzh	133 km
23 gusht	Etapa II	Lodzh – Torun	208 km
24 gusht	Etapa III	Torun - Olsztyn	196 km
25 gusht	Etapa IV	Olsztyn - Gdynia	193 km
26 gusht	-	Një ditë pushim në Gdynia	-
27 gusht	Etapa V	Gdynia - Bydgoszcz	176 km
28 gusht	Etapa VI	Bydgoszcz - Poznan	144 km
29 gusht	Etapa VII	Poznan - Wroclaw	183 km
30 gusht	Etapa VIII	Wroclaw - Katowice	187 km
31 gusht	Etapa IX	Katowice - Zakopane	186 km
1 shtator	-	Një ditë pushim në Zakopane	-
2 shtator	Etapa X	Zakopane - Krakov	110 km
3 shtator	Etapa XI	Krakov - Kielce	120 km
4 shtator	Etapa XII	Kielce - Varshavë	181 km

*Tabela tregon itinerarin e garës, i cili përfshinte disa qytete të Polonisë.<sup>19</sup>*

Gjatë vitit 1949 u zhvilluan një sërë takimesh ndërmjet përfaqësuesve diplomatikë të Shqipërisë dhe Polonisë, ku u trajtuan çështje të ndryshme, përfshirë edhe ato me karakter kulturor. Një ndër këto takime u realizua më 6 gusht 1949<sup>20</sup>, mes Llambi Dishnicës, përfaqësues i palës shqiptare, dhe Dora Lassman<sup>21</sup>, përfaqësuese e palës polake. Diskutimet e këtij takimi u përqendruan kryesisht në dy çështje: sigurimin e pajisjeve radiofonike dhe shtimin e bursave për studentët shqiptarë.<sup>22</sup> Pika e parë e agjendës ishte

<sup>19</sup> Po aty, fl.9-10.

<sup>20</sup> AMSZ, Dep. Departament I za lata 1949 – 1960 (państwa socjalistyczne bez NRD), sygn. Z – 7 W – 17 T – 148, Notatki z rozmów prowadzonych przez polskich dyplomatów..., dok.i.cit, fl.7.

<sup>21</sup> Dora Lassman ishte këshilltare në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe drejtuese e Kancelarisë Kryesore, si edhe drejtuese e Divizionit të Danubit në Departamentin I, duke filluar nga 1 shkurti 1949. Dziennik Urzędowy: Ministerstwa Spraw Zagranicznych, Warszawa 31 marca 1949 r., Nr.2, f.2.

<sup>22</sup> AMSZ, Dep. Departament I za lata 1949 – 1960 (państwa socjalistyczne bez NRD), sygn. Z – 7 W – 17 T – 148, Notatki z rozmów prowadzonych przez polskich dyplomatów..., dok.i.cit, fl.7.

njoftimi për dorëzimin e një radioje, fakt që mund të interpretohet si tregues i rritjes së rolit të komunikimit në marrëdhëniet diplomatike shqiptaro-polake. Bashkëpunimi në fushën e teknologjisë së komunikimit përfaqëson një element të rëndësishëm në forcimin e lidhjeve dypalëshe dhe në konsolidimin e interesave të përbashkëta. Një tjetër aspekt i rëndësishëm i takimit lidhet me vendimin e Ministrisë së Arsimit të Polonisë për të rritur numrin e bursave të ofruara për studentët shqiptarë me pesë vende shtesë. Ky vendim paraqet një hap të rëndësishëm në zhvillimin e marrëdhënieve kulturore dhe arsimore ndërmjet dy vendeve, duke dëshmuar gatishmërinë e Polonisë për të mbështetur formimin akademik të të rinjve shqiptarë dhe për të ndërtuar marrëdhënie afatgjata e të qëndrueshme në këtë fushë.<sup>23</sup>

Në raportin politik të nëntorit 1949, Shqipëria përshkruhet si një vend mik i Polonisë. Sipas raportit, gazetata “Zëri i Popullit” dhe “Bashkimi” i kushtonin vëmendje të veçantë shkrimeve mbi përgatitjet për festimin e 70-vjetorit të lindjes së Stalinit. Krahas kësaj, ato botonin edhe artikuj për arritjet e Polonisë, dhe gjatë kësaj periudhe, krahasuar me vitet e mëparshme, vihej re një rritje e dukshme e numrit të shkrimeve të dedikuara këtij vendi.<sup>24</sup> Në shtypin e kohës, vëmendja më e madhe i kushtohej zhvillimeve në dy shtete, përkatësisht Polonisë dhe Hungarisë. Në vitin 1949, në planin kulturor, pala polake shprehte gatishmërinë për të intensifikuar dhe zhvilluar më tej bashkëpunimin në këtë fushë. Deri në atë periudhë, Shqipëria kishte kultivuar kryesisht marrëdhënie të kësaj natyre me Bashkimin Sovjetik. Në raport theksohej se, deri atëherë, nga Shqipëria nuk kishte mbërritur në Poloni asnjë trupë artistike, ndërsa konsiderohej e përshtatshme që të organizohej dërgimi i një grupi të tillë për të nxitur kontaktet dhe shkëmbimet kulturore midis dy vendeve. Në këtë kontekst, si përfaqësues më i përshtatshëm dhe më i tërheqshëm për tregun polak konsiderohej një trupë vokal-koreografike, e cila më parë kishte zhvilluar aktivitetet e saj artistike në Hungari, Rumani dhe Bullgari.<sup>25</sup>

<sup>23</sup> AMSZ, Dep. Departament I za lata 1949 – 1960 (państwa socjalistyczne bez NRD), sygn. Z – 7 W – 17 T – 148, Notatki z rozmów prowadzonych przez polskich dyplomatów..., dok.i.cit, fl.7.

<sup>24</sup> AMSZ, Departament: Departament I za lata 1949 – 1960 (państwa socjalistyczne bez NRD), sygn. Z – 7 W – 18 T – 158, Raporty polityczne Rzeczpospolitej Polskiej w Tiranie, Daty Skrajne: 1949 – 1951, Państwo: Albania – Polska – PRL, Region Świata: Bałkany, Europa Środkowa, fl.1-2.

<sup>25</sup> AMSZ, Dep. Departament I za lata 1949 – 1960 (państwa socjalistyczne bez NRD), sygn. Z – 7 W – 18 T – 158, Raporty polityczne Rzeczpospolitej..., dok. i cit, fl. 2 - 4.

## Analizë e marrëdhënieve kulturore shqiptaro - polake në vitin 1950

Në vitin 1950 u evidentuan tendenca të qarta për intensifikimin e bashkëpunimit kulturor ndërmjet Shqipërisë dhe Polonisë. Më 30 janar të po këtij viti, Polonia raportonte se, në fushën e kulturës, nuk kishte ndonjë zhvillim të ri të rëndësishëm. Përpjekja për të sjellë Korin e Ushtrisë Shqiptare nuk pati sukses, pasi iniciativa e ambasadës erdhi në një kohë të vonë. Megjithatë, bashkëpunimi kulturor mund të thellohej më tej, për shembull përmes kontakteve të krijuara me rastin e organizimit të festimeve përkujtimore të Adam Mickiewicz, gjatë të cilave u zhvilluan aktivitete letrare dhe kulturore në nder të poetit polak. Personi i caktuar nga Shqipëria për koordinimin e këtyre aktiviteteve ishte Kol Jakova.<sup>26</sup>

Megjithatë, për tendencat drejt intensifikimit të bashkëpunimit kulturor dëshmon edhe një dokument tjetër i vitit 1950, i cili ofron të dhëna mbi dërgimin, nga ana e autoriteteve shqiptare, të disa certifikatave dhe dekoratave në adresë të Legatës Shqiptare në Varshavë. Këto u ishin destinuar anëtarëve të delegacionit ushtarak polak që morën pjesë në manifestimet e organizuara me rastin e festës së Ushtrisë, më 10 korrik 1949, dhe që u dekoruan nga Presidiumi i Kuvendit Popullor të Shqipërisë.<sup>27</sup>

Lista e përfituesve paraqitet në vijim:

1. Gjen. Major Gurecki Jan, dekoruar me Urdhrin e Skënderbeut, Kl. II – te.
2. Kolonel Flatto Stanislaw, dekoruar me Urdhrin e Skënderbeut, Kl. III – te.
3. Kolonel Cygan Miçisllav, dekoruar me Urdhrin e Skënderbeut, Kl. III – te.

*Tabela paraqet listën e anëtarëve të delegacionit ushtarak polak të dekoruar nga Presidiumi i Kuvendit Popullor të Shqipërisë.<sup>28</sup>*

<sup>26</sup> Po aty, fl.15.

<sup>27</sup> AMPJ, V. 1950, D. 91, fl. 1, Mbi dekorimin e disa shtetasve polakë.

<sup>28</sup> AMPJ, V. 1950, D. 91, fl. 1, Mbi dekorimin..., dok.i.cit, fl.1; AMSZ, Departament: Protokół Dyplomatyczny z lat 1945 – 1963, sygn. Z – 16 W – 3 T – 44, Protokół Dyplomatyczny - Order i odznaczenia; odznaczenia albańskie dla obywateli polskich nadane przez Prezydium Zgromadzenia Ludowego Albanii członkom polskiej delegacji wojskowej na uroczystości związane z obchodami Święta Armii Albańskiej; korespondencja, zarządzenia, notatki, Daty Skrajne: 1950 – 1951, Państwo: Albania – Polska – PRL, Ludowa Republika Albanii, Region Świata: Europa Południowa, Europa Wschodnia, fl.5.

Sipas një dokumenti të datës 30 mars 1950, Shqipëria planifikonte të nënshkruante një kontratë për blerjen e katër filmave shqiptarë. Megjithatë, duke qenë se Uran Abdi, Atashe Tregtar i Shqipërisë pranë Republikës Popullore të Polonisë, në emër të të cilit ishte lëshuar autorizimi për nënshkrimin e kontratës, ndodhej i sëmurë, u kërkua që autorizimi të lëshohej në emër të Llambi Dishincës. Ky ndryshim u miratua dhe u konfirmua nga autoritetet polake, duke lejuar kështu vijimin e procedurave për realizimin e kontratës.<sup>29</sup>

Më 1 gusht 1950, Llambi Dishnica i dërgon Ministrisë së Punëve të Jashtme të Shqipërisë nënshkrimin e kontratës së lidhur, si dhe titujt e katër filmave të blerë, të cilët do të paraqiten më poshtë në gjuhën polake dhe shqipe.<sup>30</sup>

Nr.	Emri në polonisht	Emri në shqip
1.	Ostatni Etap	Etapa e Fundit
2.	Ulica Graniczna	Rruga Kufitare
3.	Stalone Serca	Zemrat e Çelikut
4.	Zakazane Piosenki	Këngë të Ndaluar

*Tabela pasqyron katër filmat polakë të blerë nga Shqipëria, duke shfaqur titujt në gjuhën polake dhe përkthimin përkatës në shqip.<sup>31</sup>*

Më tej, raporti theksonte se katër filmat ishin të lidhur me rezistencën polake, ndërsa dy të parët shquheshin për famë ndërkombëtare. Për përkthimin e tyre, Legata rekomandoi katër studentë, të cilët do të realizonin përkthimin e nëntitujve. Për këtë punë, ata do të paguheshin nga Film Polski.<sup>32</sup>

Dokumenti arkivor i datës 24 maj 1950, i lëshuar nga Komiteti i Arteve dhe Kulturës dhe drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës Popullore të Shqipërisë, përbën një dëshmi të rëndësishme të institucionalizimit të bashkëpunimit kulturor shqiptaro-polak në kuadrin e politikës kulturore të bllokut socialist. Ai paraqet një përgjigje të strukturuar ndaj kërkesave të Legatës Polake në Tiranë, duke i artikuluar ato në formë

<sup>29</sup> AMPJ, V. 1950, D.93, fl. 32-34, Çështje të veçanta ekonomike me Poloninë: - Furnizimi i gjeneratorëve diesel nga Polonia - Mbi blerje filmash në Poloni.

<sup>30</sup> AMPJ, V. 1950, D.93, Çështje të veçanta ekonomike..., fl.36.

<sup>31</sup> Po aty, fl.36.

<sup>32</sup> Po aty, fl.36.

pikash të mirëpërcaktuara, të cilat reflektojnë një qasje operative dhe të koordinuar ndërinstytucionale.<sup>33</sup>

1. Së pari, dokumenti shpreh gatishmërinë për realizimin e një filmi dokumentar nga Ndërmarrja Kinematografike Shqiptare, i destinuar për shfaqje në sallat e kinemave vendase. Ky element duhet parë si pjesë e përdorimit të kinemasë jo vetëm për prezantimin e imazhit kulturor, por edhe për përforcimin e narrativave ideologjike të përbashkëta brenda hapësirës socialiste.<sup>34</sup>

2. Së dyti, shkresa parashikon mikpritjen e një grupi artistik polak në qytete të ndryshme të Shqipërisë, duke u shoqëruar me njoftimin për dërgimin e një grupi artistik shqiptar në Çekosllovakia dhe Bullgari, si dhe të Filarmonisë Shqiptare në Poloni në muajin korrik. Ky dimension i ndërsjellë i shkëmbimeve kulturore është tregues i përdorimit të artit dhe muzikës si instrumente të diplomacisë kulturore dhe të politikës së afrim-integritimit brenda kampit socialist.<sup>35</sup>

3. Së treti, evidentohet mundësia për vizitën e trupës së baletit polak, e kushtëzuar nga faktorë logjistikë dhe koordinues. Ky kushtëzim tregon se, pavarësisht vullnetit politik, praktikrat e bashkëpunimit kulturor përballeshin me kufizime infrastrukturore dhe burokratike.<sup>36</sup>

4. Së katërti, dokumenti trajton shkëmbimin e materialeve artistike dhe muzikore – fotografi, tablo me motive të kostumeve popullore dhe regjistrime të muzikës popullore – duke propozuar ngritjen e një komisioni të posaçëm për menaxhimin e tyre. Përjashtimi i ekspozitave shkencore nga kompetencat e Komitetit tregon ndarjen funksionale të sferave të veprimtarisë kulturore dhe ndjekjen e një organizimi strikt institucional.<sup>37</sup>

Ky burim, në analizë të fundit, ofron një pasqyrë të qartë mbi mënyrën se si marrëdhëniet kulturore shqiptaro-polake në fillim të viteve '50 artikuloleshin në nivel institucional, duke u bërë pjesë e një politike më të gjerë të “diplomacisë së butë” socialiste, ku format artistike dhe kulturore shërbenin si mjete për thellimin e lidhjeve politike dhe ideologjike.

<sup>33</sup> AMPJ, V.1950, D.98, fl.9, Mbi nënshkrimin e një marrëveshjeje kulturore me Poloninë dhe aktivitete kulturore konkrete.

<sup>34</sup> AMPJ, V. 1950, D.98, Mbi nënshkrimin..., dok. i cit, fl.9.

<sup>35</sup> Po aty, fl.9.

<sup>36</sup> Po aty, fl.9.

<sup>37</sup> Po aty, fl.9.

Gjatë muajve maj dhe qershor 1950, bisedimet midis Llambi Dishnicës<sup>38</sup> dhe Wiesław Sobierajski<sup>39</sup> tregojnë një aspekt më të gjerë të marrëdhënieve midis Shqipërisë dhe Polonisë, që shtrihet përtej politikës dhe përfshin edhe sferën kulturore, arsimore dhe sociale. Kërkesat e Dishnicës pasqyrojnë një përpjekje të qeverisë shqiptare për të mësuar nga përvoja polake dhe për të përmirësuar gjendjen brenda vendit.<sup>40</sup>

Në vazhdim paraqiten disa çështje të diskutuara, të cilat lidhen me aspektin kulturor dhe arsimor:

### **1. Kërkesa për statutet e Kishave Katolike dhe Ortodokse në Poloni**

Llambi Dishnica, si përfaqësues i qeverisë shqiptare, kërkoi kopje të statuteve të Kishave Katolike dhe Ortodokse në Poloni.<sup>41</sup> Në kontekstin e Shqipërisë së viteve 1950, e cila ndikohej fuqimisht nga politika ateiste e regjimit komunist, një informacion i tillë ishte thelbësor për të kuptuar mënyrën se si Polonia, një vend me tradita të forta katolike, rregullonte aktivitetin e kishës brenda sistemit socialist. Mbledhja e informacionit mbi rregulloret ligjore në lidhje me aktivitetet fetare kishte rëndësi për qeverinë shqiptare në formulimin e politikave shtetërore ndaj fesë.

### **2. Bursa për studentët shqiptarë**

Dishnica ngriti çështjen e bursave për studentët shqiptarë në Poloni, duke theksuar se në vitin 1949 këto nuk ishin menaxhuar nga Ministria e Arsimit, por

---

<sup>38</sup> AMSZ, Dep. Departament I za lata 1949 – 1960 (państwa socjalistyczne bez NRD), sygn. Z – 7 W – 17 T – 148, Notatki z rozmów prowadzonych przez polskich dyplomatów..., dok.i.cit, fl.10.

<sup>39</sup> Pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, Wiesław Sobierajski iu bashkua Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës Popullore të Polonisë. Në vitin 1949, ai u bë anëtar i Komitetit të Partisë PZPR brenda Ministrisë, duke luajtur një rol aktiv në formësimin e politikave diplomatike të vendit. Sobierajski ishte gjithashtu pjesëtar i Komitetit Sllav në Poloni, të themeluar në vitin 1945, një strukturë e cila synonte koordinimin e marrëdhënieve kulturore dhe politike midis shteteve sllave. Në vitin 1947, ai mori drejtimin e Departamentit Juglindor në Ministrinë e Punëve të Jashtme, duke u angazhuar në çështjet diplomatike të rajonit. Gjatë periudhës 1950–1955, Sobierajski u arrestua dhe u mbajt si i burgosur politik, një përvojë që reflekton tensionet e brendshme politike të asaj kohe. Nga 26 prilli 1963 deri më 13 shkurt 1968, ai shërbeu si ambasador i Republikës Popullore të Polonisë në Rumani, duke kontribuar në konsolidimin e marrëdhënieve dypalëshe dhe diplomacisë rajonale.

<sup>40</sup> AMSZ, Dep. Departament I za lata 1949 – 1960 (państwa socjalistyczne bez NRD), sygn. Z – 7 W – 17 T – 148, Notatki z rozmów prowadzonych przez polskich dyplomatów..., dok.i.cit, fl.10.

<sup>41</sup> Po aty, fl. 10.

nga institucione të ndryshme, çka krijonte mungesë uniformiteti në praktikat e pagesës. Bursa arrinte në 15,000 zloty, ndërsa qeveria shqiptare i shtonte secilit bursist nga 1,000 zloty. Praktikrat gjatë pushimeve verore paguheshin dhe arrinin në 9,000 - 10,000 zloty në muaj.<sup>42</sup> Mundësia për të kryer praktika profesionale dhe qasja në bursa ishte një element kyç i bashkëpunimit arsimor midis dy vendeve, duke treguar rëndësinë e arsimit në zhvillimin profesional të të rinjve shqiptarë.

### **3. Ftesa e një gazetari për zgjedhjet për Parlamentin e Shqipërisë**

Dishnica u kërkua të ftonte gazetarë për të bërë raportim mbi zgjedhjet parlamentare të 28 majit 1950, duke sugjeruar veçanërisht praninë e një gazetari të lidhur me Partinë e Punëtorëve të Bashkuar Polakë (PZPR).<sup>43</sup> Kjo tregon përpjekjen për të forcuar marrëdhëniet diplomatike dhe për të promovuar imazhin e Shqipërisë në Poloni.

### **4. Kërkesa për materiale mbi luftën kundër analfabetizmit**

Në kontekstin e fushatës kundër analfabetizmit, Dishnica kërkoi materiale që mund të shërbenin si modele për autoritetet shqiptare.<sup>44</sup> Polonia, e cila gjatë viteve 1950 zhvilloi aktivitete intensive në këtë fushë, mund të shërbente si model për Shqipërinë, duke kontribuar në uljen e nivelit të analfabetizmit dhe përmirësimin e arsimit bazë.

### **5. Ndërhyrje në lidhje me praktikrat verore për studentët**

Dishnica kërkoi ndërhyrjen e Ministrisë së Arsimit për të siguruar që katër studentë shqiptarë nga Akademia e Minierave në Kraków, të përfundonin stazhet e tyre në minierat e metaleve “Nowy Orzeł Biały”, të cilat nuk ishin përfshirë në listën zyrtare.<sup>45</sup> Kjo tregon rëndësinë e stazheve profesionale për arsimin teknik dhe profesional në Shqipëri, si dhe ndikimin e tyre në përmirësimin e kualifikimeve dhe karrierës së të rinjve.

---

<sup>42</sup> AMSZ, Dep. Departament I za lata 1949 – 1960 (państwa socjalistyczne bez NRD), sygn. Z – 7 W – 17 T – 148, Notatki z rozmów prowadzonych przez polskich dyplomatów..., dok.i.cit, fl. 10.

<sup>43</sup> Po aty, fl. 11.

<sup>44</sup> Po aty, fl.11.

<sup>45</sup> AMSZ, Dep. Departament I za lata 1949 – 1960 (państwa socjalistyczne bez NRD), sygn. Z – 7 W – 17 T – 148, Notatki z rozmów prowadzonych przez polskich dyplomatów..., dok.i.cit, fl.11.

## 6. Probleme shëndetësore të oficerëve dhe ushtarëve të sëmurë

Dishnica ngriti çështje që lidhen me akomodimin dhe kujdesin shëndetësor për 60 oficerë dhe ushtarë të sëmurë, duke kërkuar informacion mbi vendet e akomodimit dhe opinionet mjekësore mbi gjendjen e tyre. Problemet shëndetësore, si tuberkulozi (20 pacientë), plagët (20 të plagosur) dhe procesi i rikuperimit (20 të rikuperuar), ishin çështje të rëndësishme, veçanërisht në kontekstin e vështirësive të pasluftës në trajtim dhe rehabilitim.<sup>46</sup>

## 7. Bashkëpunimi në fushën e filmit

Dishnica diskutoi nënshkrimin e një marrëveshjeje për bashkëpunim kinematografik midis Polonisë dhe Shqipërisë, duke vënë në dukje nevojën për përcaktimin e kushteve të saj. Filmi, si medium kulturor, mund të përdoret për promovimin e ideve socialiste dhe forcimin e lidhjeve kulturore midis dy vendeve.<sup>47</sup>

## 8. Udhëtime të studentëve shqiptarë në Shqipëri

Dishnica ngriti gjithashtu çështjen e 46 studentëve që jetonin në Poloni, ku 22 prej tyre planifikoheshin të ktheheshin në Shqipëri. Kjo ngriti dy sfida kryesore: bursat verore për 24 studentët e mbetur dhe kushtet e qëndrimit të tyre. Bursat u përcaktuan sipas nevojave praktike dhe do të paguheshin për 10 muaj. Megjithatë, çështjet e vizave dhe rregulloret administrative mbeteshin sfida për lëvizshmërinë e studentëve shqiptarë.<sup>48</sup>

Bisedat midis Dishnicës dhe Sobierajskit në maj-qershor 1950 ilustron marrëdhënien komplekse midis Polonisë dhe Shqipërisë gjatë Luftës së Ftohtë. Temat e diskutuara, duke përfshirë arsimin, luftën kundër analfabetizmit, shëndetësinë dhe bashkëpunimin kulturor, tregojnë përkushtimin e qeverisë shqiptare ndaj modernizimit dhe forcimit të lidhjeve me Poloninë. Konteksti politik dhe shoqëror i viteve 1950 nxori në pah sfidat me të cilat u përballën të dy vendet, të cilat ndikuan në zhvillimin e mëvonshëm të marrëdhënieve të tyre ndërkombëtare.

Në dokumentin e datës 16 qershor 1950 jepen të dhëna mbi broshurën që po përgatitej nga gazetari polak Jerzy (George) Drawnowski<sup>49</sup>. Qysh nga

<sup>46</sup> Po aty, fl.12.

<sup>47</sup> Po aty, fl.12.

<sup>48</sup> Po aty, fl.12.

<sup>49</sup> AMPJ, V. 1950, D.99, fl.1, Mbi veprimtarinë e publicistëve dhe gazetarëve polakë në drejtim të vendit tonë.

shkurti i vitit 1949, ai kishte ardhur në Sofja si korrespondent i Agjencisë Telegrafike Polake, për krejt Ballkanin. G. Drawnowski mori angazhim për të përgatitur një broshurë mbi Shqipërinë. Sipas informacionit të marrë nga studentët që kishin ardhur atje, broshura ende nuk ishte publikuar, dhe gazetari vazhdonte punën për përgatitjen e saj.<sup>50</sup>

Më 19 tetor 1950, i ngarkuari me punë i Republikës Popullore të Shqipërisë në Sofje, Anastas Dushku, raportoi mbi një bisedë të zhvilluar me gazetarin polak Jerzy (George) Drawnowski, lidhur me përgatitjen e një botimi propagandistik për Shqipërinë. Sipas dëshmisë së Drawnowskit, puna për broshurën kishte filluar në vitin 1949 dhe ishte përfunduar në një version fillestar, por pas një rishikimi të hollësishëm autori kishte arritur në përfundimin se teksti nuk ishte i përshtatshëm për botim në formën ekzistuese, duke vendosur kështu të rifillonte procesin e përpunimit.<sup>51</sup>

Në kuadër të detyrimeve të tij kontraktore ndaj ndërmarrjes botuese *Wiedza Powszechna*, Drawnowski ishte i angazhuar ta dorëzonte versionin e përfunduar të broshurës deri më 15 nëntor 1950. Titulli paraprak i parashikuar ishte “*Shqipëria në rrugën e progresit dhe në luftë për paqe të qëndrueshme*”; megjithatë, raporti i Dushkut nënvizonte se ky titull mund t’i nënshtrohej ndryshimeve në fazën përfundimtare të redaktimit. Broshura do të përmbante afërsisht gjashtëdhjetë faqe dhe ishte planifikuar të shtypej në një tirazh prej 50.000 ekzemplarësh, duke pasur për qëllim shpërndarjen e gjerë në publikun polak.<sup>52</sup>

Struktura e saj ishte konceptuar në disa kapituj tematikë, të cilët trajtonin aspekte të zhvillimit politik, ekonomik dhe kulturor të Shqipërisë socialiste, duke theksuar arritjet pas çlirimit dhe rolin e saj në lëvizjen ndërkombëtare për paqe. Përmbajtja e këtij botimi reflektonte një strategji të mirëmenduar propagandistike të orientuar nga bashkëpunimi polako-shqiptar dhe ishte pjesë e një fushate më të gjerë të vendeve të kampit socialist për të promovuar imazhin e tyre në arenën ndërkombëtare.<sup>53</sup>

---

<sup>50</sup> Po aty, fl.1.

<sup>51</sup> AMPJ, V. 1950, D.99, Mbi veprimtarinë..., dok.i.cit, fl.4.

<sup>52</sup> Po aty, fl.4.

<sup>53</sup> AMPJ, V. 1950, D.99, Mbi veprimtarinë..., dok.i.cit, fl.4.

Kapitujt e parashikuar ishin si më poshtë:

<b>KAPITULLI I – HYRJE</b>	
1.	Pozita gjeografike
2.	Gjuha dhe literatura
3.	Mbi historinë e Shqipërisë
4.	Mbi zakonet, traditat, nga e kaluara jonë, etj.
<b>KAPITULLI II – (Pjesa bazë) – Shqipëria vend i Demokracisë Popullore</b>	
1.	Industria
2.	Bujqësia
3.	Arsimi dhe Kultura
4.	Ndërhyrjet e imperialistëve
<b>KAPITULLI III – Shqipëria si pararojë e luftës për paqe</b>	

*Tabela paraqet ndarjen në kapituj të broshurës së gazetarit*

*Jerzy (George) Drawnowski.<sup>54</sup>*

Qysh në fillim të muajit korrik të vitit 1950 u paralajmëruan aktivitete kulturore. Në këtë kuadër, pala polake pati kontakte me Drejtorin e Komitetit për Kulturë dhe Art, z. Fatos Stamo, si dhe me znj. Frashëri. Programi i planifikuar parashikonte një ekspozitë afishesh, një ekspozitë fotografike, pjesëmarrjen e një grupi artistik dhe shfaqjen e filmave.<sup>55</sup>

Në kuadër të marrëdhënieve kulturore shqiptaro-polake, u trajtua edhe mundësia e organizimit të një turneu të ansambllit të baletit shqiptar në Poloni. Ky propozim lidhej jo vetëm me shkëmbimet artistike, por edhe me përpjekjen për të reflektuar në Poloni jehonën e përvjetorëve të figurave të rëndësishme të letërsisë shqiptare, të cilat në Shqipëri u shënuan me një program të gjerë veprimtarish, duke arritur kulmin në tetor të vitit 1950. Përvjetorët kishin në qendër shkrimtarë të shekullit XIX, të cilët me veprën e tyre ndihmuan në konsolidimin e gjuhës dhe të letërsisë kombëtare. Në mars u shënuua 55-vjetori i vdekjes së Konstandin Kristoforidhit, autor i gramatikës së parë të shqipes; në qershor 100-vjetori i lindjes së Sami Frashërit, mendimtar dhe publicist me ndikim të gjerë; në korrik 20-vjetori i vdekjes së Andon Zako Çajupit, poet i ideve atdhetare; ndërsa në tetor 50-vjetori i ndarjes nga jeta i Naim Frashërit,

<sup>54</sup> Po aty, fl.4.

<sup>55</sup> AMSZ, Dep. Departament I za lata 1949 – 1960 (państwa socjalistyczne bez NRD), sygn. Z – 7 W – 18 T – 158, Raporty polityczne Rzeczpospolitej..., dok.i.cit, fl.43-44.

figurë qendrore e letërsisë së Rilindjes Kombëtare.<sup>56</sup>

Përmes këtyre përvjetorëve u synua të afirmohej një narrativë kulturore e lidhur me procesin e ringjalljes kombëtare, ndërkohë që në nivel ndërkombëtar ato shërbenin si instrument për të forcuar imazhin e Shqipërisë. Në këtë kuadër, përfshirja e Polonisë në veprimtaritë kulturore shqiptare shihej si një hap i rëndësishëm për zgjerimin e kontakteve dypalëshe dhe për krijimin e një baze më të gjerë të bashkëpunimit kulturor. Sipas raportimit të Bolesław Jeleń, përvjetori i kushtuar Naim Frashërit përfaqësonte kulmin e këtij cikli dhe njëkohësisht momentin më të përshtatshëm për ta pasqyruar edhe në Poloni dimensionin kulturor shqiptar.<sup>57</sup>

### **Java e Miqësisë Shqiptaro-Polake: organizimi, realizimi dhe dimensionin propagandistik**

Java e Miqësisë Shqiptaro-Polake e vitit 1950 përbën një shembull të rëndësishëm të bashkëpunimit kulturor dhe politik midis vendeve të Bllokut Lindor, në kuadër të strategjisë së gjerë të ndërtimit të marrëdhënieve diplomatike dhe propagandistike të udhëhequra nga Bashkimi Sovjetik dhe satelitët e tij. Shkëmbimi kulturor luajti një rol kyç në organizimin e këtij eventit, i cili synonte jo vetëm forcimin e lidhjeve dypalëshe midis Shqipërisë dhe Polonisë, por edhe konsolidimin e aleancës politike dhe promovimin e vlerave ideologjike të përbashkëta. Një nga elementët qendrorë të programit ishte prezantimi i filmave polakë, përfshirë Etapa e Fundit, Rruga e Gjerë dhe 1 Maji, të shoqëruar me komente në gjuhën frënge. Shfaqjet synonin të evidentonin arritjet artistike dhe ideologjike të Republikës Popullore të Polonisë. Zgjedhja e gjuhës frënge, e cila në atë periudhë shërbente si gjuhë ndërkombëtare e komunikimit kulturor, lehtësoi perceptimin e filmave nga publiku shqiptar dhe simbolizoi hapjen ndaj dimensionit ndërkombëtar të propagandës socialiste.<sup>58</sup>

Eventi, i organizuar më 13 korrik në kopshtin e Shoqërisë Ndërlidhëse Kulturore Shqipëri - BRSS, për përfaqësues të shtypit, diplomacisë dhe botës së kulturës, shënoi fillimin e një serie aktiviteteve kulturore. Shfaqja e filmave polakë, pavarësisht mungesës së përkthimit në gjuhën shqipe, tërhoqi një audiencë të gjerë si në kryeqytet, ashtu edhe në provinca. Në këtë kontekst,

<sup>56</sup> Po aty, fl.43-44.

<sup>57</sup> Po aty, fl.44.

<sup>58</sup> Po aty, fl.59.

vlen të theksohet përzgjedhja e filmit Etapa e Fundit, i cili trajtonte historinë e krimeve naziste, duke përfaqësuar jo vetëm dimensionin artistik, por edhe atë edukativ dhe ideologjik të programit.<sup>59</sup>

Java e Miqësisë Shqiptaro-Polake nisi më 21 korrik 1950 dhe përfshiu një sërë aktivitete me rëndësi diplomatike dhe propagandistike. Gjatë këtij eventit, Mihal Prifti, Zëvendësministri i Jashtëm i Shqipërisë, mbajti një fjalim në të cilin theksoi lidhjet historike të dy vendeve gjatë luftës për pavarësi, miqësinë polako-shqiptare dhe rolin kyç të Bashkimit Sovjetik në çlirimin e të dy kombeve.<sup>60</sup>

Theksi mbi rëndësinë e Bashkimit Sovjetik ishte tipik për retorikën propagandistike të periudhës, ndërsa brohoritja e emrave të udhëheqësve komunistë, përfshirë Stalinin, Bierutin dhe Enver Hoxhën, shërbente si shprehje e besnikërisë politike ndaj udhëheqësve të Bllokut Lindor.<sup>61</sup> Nga ana polake, Anna Milska, duke folur në emër të delegacionit të saj, shprehu ndjenja miqësie dhe solidariteti ndaj popullit shqiptar, duke theksuar rrugën e përbashkët të të dy kombeve drejt ndërtimit të socializmit.<sup>62</sup>

Deklaratat e tilla nuk përbënin vetëm shprehje diplomatike, por edhe një instrument propagandistik, i cili synonte të forconte idenë e unitetit socialist dhe të evidentonte marrëdhëniet e ngushta midis vendeve të Bllokut Lindor. Në këtë mënyrë, fjalimet dhe përshkrimet e eventit kontribuan në ndërtimin e një imazhi të mbështetjes së ndërsjellë dhe aspiratave të përbashkëta politike, duke synuar konsolidimin e aleancës socialiste në perceptimin publik.

Megjithatë, analiza e organizimit të Javës së Miqësisë Shqiptaro-Polake evidenton disa mangësi në realizimin e saj praktik. Dekorimi i kryeqytetit ishte relativisht modest, ndërsa përpjekjet për të promovuar arritjet polake përmes ekspozitave fotografike nuk arritën të përmbushnin pritshmëritë, gjë që mund të lidhet me kohën e kufizuar të përgatitjeve. Gjatë eventit, pranë portretit të Presidentit Bolesław Bierut në ndërtesën e bashkisë u vendosën vetëm dy

<sup>59</sup> AMSZ, Dep. Departament I za lata 1949 – 1960 (państwa socjalistyczne bez NRD), sygn. Z – 7 W – 18 T – 158, Raporty polityczne Rzeczpospolitej..., dok.i.cit, fl.59.

<sup>60</sup> AMSZ, Dep. Departament I za lata 1949 – 1960 (państwa socjalistyczne bez NRD), sygn. Z – 7 W – 18 T – 158, Raporty polityczne Rzeczpospolitej..., dok.i.cit, fl.59-60; Trybuna Ludu, Organ KC Polskiej Zjednoczonej Partii Robotniczej, Warszawa – Środa, 26 lipca 1950 r. Nr. 203 (575) Rok III, f.1; Trybuna Ludu, Organ KC Polskiej Zjednoczonej Partii Robotniczej, Warszawa – Środa, 26 lipca 1950 r. Nr. 202 (574) Rok III, f.1.

<sup>61</sup> AMSZ, Dep. Departament I za lata 1949 – 1960 (państwa socjalistyczne bez NRD), sygn. Z – 7 W – 18 T – 158, Raporty polityczne Rzeczpospolitej..., dok.i.cit, fl.59-60.

<sup>62</sup> Dziennik Zachodni, Katowice dnia 26 lipca 1950 roku, Nr.169 (1722), AB, f.1.

flamuj polakë, duke reflektuar një prezencë simbolike dhe të kufizuar vizuale të shtetit mik.<sup>63</sup>

Nga ana tjetër, mediat shqiptare, përfshirë shtypin dhe radion, luajtën një rol vendimtar në informimin e publikut dhe promovimin e një imazhi pozitiv të Polonisë. Gjatë Javës së Miqësisë u botuan artikuj lajmesh, analiza dhe raporte mbi ngjarjet, duke përfshirë shkrime të autorëve shqiptarë, si dhe ribotime nga shtypi sovjetik dhe revista “Paralléle 50”, që trajtonin jetën ekonomike, sociale dhe kulturore të Polonisë.<sup>64</sup> Ky aktivitet mediatik kontribuoi në përforsimin e perceptimit të marrëdhënieve të ngushta dhe miqësore midis të dy vendeve, duke kompensuar disa nga mangësitë e organizimit praktik të eventit.

“Java e Miqësisë”, e organizuar në Shqipëri me pjesëmarrjen e përfaqësuesve polakë, evidentoi një kontrast të qartë midis aktiviteteve të planifikuara dhe realizimit praktik të tyre. Nga një këndvështrim historik, ky aktivitet pasqyron specifikën e marrëdhënieve kulturore dhe politike midis Shqipërisë dhe Polonisë në periudhën e pasluftës, duke ilustruar rolin e propagandës socialiste dhe përpjekjen për konsolidimin e solidaritetit ndërkombëtar. Pjesëmarrja e Polonisë kishte për qëllim demonstrimin e solidaritetit dhe mbështetjen e ndërtimit të një imazhi pozitiv të vendit midis klasës punëtore shqiptare. Megjithatë, realizimi i aktiviteteve u ndikua nga vështirësitë organizative dhe nga qëndrimet e pjesëmarrësve, duke reflektuar kufizimet praktike të përgatitjeve.<sup>65</sup> Aktivitetet kryesore përfshinin koncerte, akademi, takime dhe leksione, të cilat synonin njohjen e komunitetit shqiptar me kulturën dhe arritjet e Republikës Popullore të Polonisë. Performancat artistike u zhvilluan jo vetëm në Tiranë, por edhe në qytete të tjera si Durrësi, Korça dhe Shkodra. Një rast i veçantë ishte koncerti në ajër të hapur në Durrës, i cili tërhoqi rreth 8,000 dëgjues, në kontrast me ngjarjet në kryeqytet, të kufizuara në një audiencë teatrale prej 800 vetash. Komitetet vendore treguan një nivel më të lartë iniciative dhe fleksibiliteti sesa organizatorët

<sup>63</sup> AMSZ, Dep. Departament I za lata 1949 – 1960 (państwa socjalistyczne bez NRD), sygn. Z – 7 W – 18 T – 158, Raporty polityczne Rzeczpospolitej..., dok.i.cit, fl.60.

<sup>64</sup> Trybuna Ludu, Organ KC Polskiej Zjednoczonej Partii Robotniczej, Warszawa – Czwartek, 27 lipca 1950 r. Nr. 204 (575) Rok III, f.1; AMSZ, Dep. Departament I za lata 1949 – 1960 (państwa socjalistyczne bez NRD), sygn. Z – 7 W – 18 T – 158, Raporty polityczne Rzeczpospolitej..., dok.i.cit, fl.60-61.

<sup>65</sup> AMSZ, Dep. Departament I za lata 1949 – 1960 (państwa socjalistyczne bez NRD), sygn. Z – 7 W – 18 T – 158, Raporty polityczne Rzeczpospolitej..., dok.i.cit, fl.61.

qendrorë, duke reflektuar përpjekjet e komuniteteve lokale për të përmirësuar organizimin dhe për të maksimizuar efektin e aktiviteteve kulturore dhe propagandistike.<sup>66</sup>

Në kuadrin e bashkëpunimit ndërkombëtar midis Shqipërisë dhe Polonisë, u evidentuan një sërë vështirësish logjistike që ndikuan në realizimin e aktiviteteve të planifikuara gjatë Javës së Miqësisë. Në këtë kontekst, dështimi për të dërguar materialet promovuese nga Vjena, si dhe anulimi i një ndeshjeje futbolli me ekipin polak, e cila ishte pritur me shumë interes nga publiku shqiptar, përbëjnë tregues të këtyre sfidave. Përveç dimensionit sportiv, kjo ndeshje kishte një rëndësi ekonomike të konsiderueshme, pasi autoritetet shqiptare synonin të përdornin të ardhurat e saj për të mbuluar shpenzimet e organizimit të Javës.<sup>67</sup> Mungesa e një perceptimi të plotë të pritshmërive të palës shqiptare në këtë çështje ka mundur të ndikojë negativisht në arritjen e objektivave kryesore të ngjarjes, të cilat lidheshin me promovimin e integritetit dhe forcimin e marrëdhënieve miqësore ndërmjet dy vendeve.

Në aspektin kulturor, pritja e delegacionit artistik polak nga publiku shqiptar ishte në përgjithësi pozitive. Solistë të njohur, si Barbara Hesse-Bukowska, Halina Słonicka dhe Jerzy Adamczewski, ofruan performanca artistike me standarde të larta, të cilat u vlerësuan pozitivisht nga audienca vendase. Megjithatë, disa pjesëmarrës shfaqën qëndrime që u perceptuan nga shqiptarët si ngurrim ose mungesë interesi ndaj kulturës dhe çështjeve vendase. Ky fenomen evidenton sfidat e përshtatjes së aktorëve kulturorë me kontekstin specifik të Republikës Popullore të Shqipërisë, ku pritej jo vetëm një angazhim i plotë ideologjik, por edhe një nivel i lartë i mirëkuptimit dhe bashkëpunimit reciprok.<sup>68</sup>

Nga perspektiva e ndërveprimeve individuale, veprimtaria e anëtarëve të delegacionit polak, si Anna Milska dhe Krzysztof Gruszczyński, të cilët angazhuan dialog të drejtpërdrejtë me partnerë dhe shkrimtarë shqiptarë, u vlerësua pozitivisht dhe ilustroi rëndësinë e iniciativës personale në konsolidimin e marrëdhënieve bilaterale. Dallimet e perceptueshme në qëndrimet individuale të delegatëve evidencuan ndikimin e faktorëve subjektivë në proceset e diplomacisë kulturore dhe ishin të domosdoshme për zhvillimin e mëtejshëm të marrëdhënieve polako-shqiptare.

---

<sup>66</sup> Po aty, fl.61.

<sup>67</sup> Po aty, fl.61.

<sup>68</sup> Po aty, fl. 62-63.

Shoqëria shqiptare, e orientuar nga vlerësimi i besnikërisë dhe angazhimit ideologjik, priste që delegatët nga vendet socialiste të ishin plotësisht të informuar mbi realitetet politike vendase dhe të demonstrojnë sjellje në përputhje me pritshmëritë ideologjike.<sup>69</sup>

Ngjarjet e “Javës së Miqësisë” kulmuan me dërgimin e një telegrami drejtuar Kryeministrit Enver Hoxha, i cili shprehte mirënjohje për mikpritjen dhe vlerësim për arritjet e Shqipërisë. Megjithatë telegrami kishte karakter simbolik, ai luajti një rol të rëndësishëm në formësimin e imazhit të Polonisë si partner i besueshëm në kuadër të botës socialiste, duke lënë një përshtypje pozitive në qarqet politike shqiptare.<sup>70</sup>

### **Pjesëmarrja në konferenca dhe aktivitete shkencore, kulturore e sportive dypalëshe gjatë vitit 1950**

Gjatë vitit 1950, në Poloni u zhvilluan disa kongrese dhe konferenca ku ftoheshin delegatë shqiptarë. Më 13 prill 1950, në Varshavë u mbajt Kongresi i Shoqatës së Artistëve Polakë, ku pjesëmarrësit shqiptarë duhej të mbulonin vetë shpenzimet e udhëtimit dhe qëndrimit.<sup>71</sup> Më 28 - 29 maj, në Szczecin u zhvillua Kongresi i Shoqatës Polake të Mjekësisë Gjinekologjike, ku u ftuan dy deri në tre mjekë shqiptarë.<sup>72</sup>

Bolesław Jeleń njoftoi gjithashtu se më 28 qershor do të mbahej Kongresi i Dermatologjisë<sup>73</sup> dhe më 24 - 28 qershor Kongresi i Shkrimtarëve në Poloni, ku ftohej një delegacion shqiptar.<sup>74</sup> Më 29 qershor - 1 korrik u mbajt Kongresi i Shkrimtarëve Polakë, me pjesëmarrjen e delegatëve shqiptarë.<sup>75</sup>

Më 24 shtator, në Lodz, u zhvillua Kongresi i Parë i Shoqatës Polake për Endokrinologji, ku u ftuan dy deri në katër mjekë shqiptarë, me shpenzimet e mbuluara nga vetë delegacioni.<sup>76</sup> Ndërsa më 5–7 tetor, në Krakov u mbajt Kongresi i VII i Shoqatës Polake të Pediatrisë, ku pjesëmarrësit shqiptarë

<sup>69</sup> AMSZ, Dep. Departament I za lata 1949 – 1960 (państwa socjalistyczne bez NRD), sygn. Z – 7 W – 18 T – 158, Raporty polityczne Rzeczpospolitej..., dok.i.cit, fl.62-64.

<sup>70</sup> Po aty, fl.64.

<sup>71</sup> AMPJ, V.1950, D.101, fl.15. Dokumente mbi ftesat në kongrese dhe aktivitete të tjera shkencore, kulturore e sportive.

<sup>72</sup> Po aty, fl.4.

<sup>73</sup> Po aty, fl.3.

<sup>74</sup> Po aty, fl.3.

<sup>75</sup> AMPJ, V.1950, D.101, Dokumente mbi ftesat..., dok.i.cit, fl.21.

<sup>76</sup> Po aty, fl.1.

duhej të mbulonin vetë shpenzimet.<sup>77</sup> Nga 11 deri më 16 dhjetor, në Krakov u zhvillua Konferenca Nacionale e Artit Polak, ku ishte i ftuar një delegacion shqiptar.<sup>78</sup>

Megjithatë, dokumentacioni i kohës tregon se në shumicën e këtyre kongreseve Shqipëria nuk dërgonte delegatë, kryesisht për shkak të mungesës së stafit teknik ose të kohës së shkurtër për përgatitje.

### **Nënshkrimi i marrëveshjes për shkëmbime kulturore midis Polonisë dhe Shqipërisë, 2 dhjetor 1950**

Marrëveshja për Bashkëpunim Kulturor ndërmjet Republikës së Polonisë dhe Republikës Popullore të Shqipërisë u nënshkrua në Tiranë më 2 dhjetor 1950. Dokumenti përmban 11 nene, të cilat përcaktojnë parimet e bashkëpunimit kulturor midis dy vendeve, me qëllim forcimin e lidhjeve miqësore dhe promovimin e shkëmbimeve kulturore.<sup>79</sup>

Marrëveshjen e nënshkruan Eugenia Krassowska, Nënsekretare Shteti në Ministrinë e Arsimit të Lartë dhe Arsimit Profesional, në përfaqësim të Qeverisë së Republikës së Polonisë, dhe Kahreman Ylli, Ministër i Arsimit, në përfaqësim të Qeverisë së Republikës Popullore të Shqipërisë.<sup>80</sup>

---

<sup>77</sup> Po aty, fl.2.

<sup>78</sup> Po aty, fl.23.

<sup>79</sup> AMSZ, Departament: Departament I za lata 1949 – 1960 (państwa socjalistyczne – bez NRD), sygn. Z – 7 W – 19 T – 167, Polska – albańska umowa kulturalna, dokumenty ratyfikacyjne, roczne plany współpracy kulturalnej, materiały do negocjacji, interwencje, uwagi do projektów planów, ocena ich realizacji, protokoły z posiedzeń Komisji Mieszanej, Daty Skrajne: 1951 – 1960, Państwa: Albania, Polska, Polska PRL, Region Świata: Bałkany, Europa Południowa, Europa Środkowa, fl.7; Dziennik Zachodni, Czytelnik, Środa 6 grudnia 1950 r., Nr.336 (2085) – Rok VI, fl.7-10, Zygmunt Kaczmarek, “Stosunki między Polską a Albanią,” në *Stosunki Polski z innymi państwami socjalistycznymi*, red. Czesław Mojszewicz (Warszawa: Państwowe Wydawnictwo Naukowe, 1973), 199.

<sup>80</sup> AMSZ, Dep. Departament I za lata 1949 – 1960 (państwa socjalistyczne – bez NRD), sygn. Z – 7 W – 19 T – 167, Polska – albańska umowa kulturalna..., dok.i.cit, fl.7.

Në vazhdim po paraqesim artikujt e marrëveshjes:

<b>Artikulli I</b>
Dy palët e lartpërmendura kontraktajnë se do të ndihmojnë dhe do të lehtësojnë bashkëpunimin ndërmjet instituteve dhe shoqërive shkencore, organizatave me karakter kulturor dhe arsimor, sindikatave profesionale, organizatave të rinisë dhe sportit, në radhë të parë, duke ftuar reciprokisht përfaqësues të këtyre institucioneve, si dhe duke shkëmbyer grupe artistike, duke organizuar ndërmarrje kulturore, stazhe profesionale, kampe dhe kurse.
<b>Artikulli II</b>
Dy palët e larta kontraktuese vendosin: a) Të fusin në programet arsimore të seksioneve përkatëse të instituteve me gradë universitare në fushën e historisë, letërsisë, gjeografisë dhe shkencave ekonomike, njohuritë për palën tjetër kontraktuese. b) T'u garantojnë dijetarëve të të dyja palëve lirinë në kërkimet shkencore të kryera në institucionet me karakter shkencor dhe studimor, duke u lehtësuar studimin nga afër të koleksioneve të muzeve, arkivave dhe bibliotekave që ndodhen në territorin e palës tjetër kontraktuese, brenda kufizimeve juridike në fuqi për këtë sektor. c) Të përkrahin studimet reciproke në universitetet dhe institutet shkencore, të akordohen bursa studentëve dhe dijetarëve, të lehtësojnë shkëmbimin e aktiviteteve në fushën e arsimit dhe sindikalizmit. d) Të shkëmbejnë informata mbi rezultatet dhe reformat në fushën e demokratizimit të arsimit shkollor, të jetës shkencore dhe kulturore, me qëllim që të bëhet e mundur njohja reciproke e realizimeve në këtë fushë. e) Të favorizohet mësimi i gjuhës shqipe në Poloni dhe i gjuhës polake në Shqipëri. f) Të bëjnë të gjitha përpjekjet e tyre me qëllim që, në manualët që përdoren për shkollat e gradës së parë dhe të dytë, si edhe në gazetatat për fëmijë dhe të rinj, të futen lexime dhe artikuj mbi jetën e palës tjetër kontraktuese.
<b>Artikulli III</b>
Dy palët e larta kontraktuese angazhohen reciprokisht të lehtësojnë hyrjen në vendin e tyre të veprave letrare dhe shkencore të palës tjetër, duke favorizuar përkthimet nga shqipja në polonisht dhe nga polonishtja në shqip, si dhe të lehtësojnë punën e botimit dhe të shkëmbimit të librave, të periodikëve, të shtypit dhe të botimeve të tjera.
<b>Artikulli IV</b>
Dy palët e larta kontraktuese do të organizojnë në vendet e tyre ekspozita dhe të përkrahin vënien në skenë të pjesëve teatrale, të veprave muzikore dhe të filmave nga repertori i palës tjetër.
<b>Artikulli V</b>
Dy palët e larta kontraktuese do të përkrahin lidhjen dhe bashkëpunimin e ngushtë ndërmjet radio-përhapjeve të dy vendeve.

**Artikulli VI**

Dy palët e larta kontraktuese do të përkrahin aktivitetin e agjencive të shtypit dhe të korrespondentëve.

**Artikulli VII**

Për të bërë të mundur zbatimin e vendimeve të theksuara në artikujt e më sipër, do të krijohet, në afat të shkurtër, një komision miks polako-shqiptar i përbërë nga dy nënkomisione, që do të kenë qendrën njëri në Varshavë e tjetri në Tiranë.

Në krye të çdo nënkomisioni do të vihet një president i emëruar nga Qeveria e vendit, në të cilin punon nënkomisioni. Në çdo nënkomision do të hyjnë edhe dy përfaqësues të Ministrive të interesuara dhe përfaqësues të legatës së palës tjetër kontraktuese.

Përbërja e nënkomisioneve do t'i nënshtrohet për aprovim të dy palëve të larta kontraktuese.

Çdo nënkomision mund të ftojë për bashkëpunim si këshilltar ekspert të zgjedhur nga përfaqësuesit e instituteve shkencore, kulturore, sindikale dhe artistike.

**Artikulli VIII**

Sesionet e komisionit miks do të mbliidhen një herë në vit, me radhë në Varshavë e në Tiranë. Sesioni i parë do të mbliidhet në Varshavë, jo më vonë se një muaj pas shkëmbimit të dokumenteve të ratifikimit.

Presidenti i sesioneve të komisionit miks në Varshavë do të emërohet çdo herë nga Qeveria Polake, dhe presidenti i sesioneve në Tiranë do të emërohet nga Qeveria Shqiptare.

Komisioni miks do të vendosë një rregullore, sipas të cilës do të kryejnë punimet e tyre komisioni dhe nënkomisionet.

Shpenzimet e komisionit miks do të mbulohen gjysmë nga të dy palët, ndërsa shpenzimet e çdo nënkomisioni do të jenë në ngarkim të vendit ku punon nënkomisioni.

**Artikulli IX**

Komisioni do të përpunojë në radhë të parë një plan zbatimi të këtij akordi.

Plani do të përfshijë hollësitrat që nuk janë përmendur në paragrafët e tjerë të akordit.

Plani do të aprovet nga të dy qeveritë. Ky plan mund të ndryshohet ose të plotësohet sipas dëshirës së njëres palë dhe me një marrëveshje të dy palëve.

Komisioni do t'iu paraqesë për aprovim të dy qeverive propozimet e tij në lidhje me realizimin e këtij akordi dhe ato që i përkasin të gjitha çështjeve të tjera që i janë dërguar nga të dy qeveritë.

**Artikulli X**

Të gjitha marrëveshjet e lidhura deri tani mes institucioneve tona shkencore dhe kulturore respektive mbeten në fuqi, për sa kohë që nuk hyjnë në kundërshtim me vendimet e marra konform këtij akordi. Në të ardhmen, marrëveshjet e tilla do të lidhen në kuadër të komisioneve miks.

**Artikulli XI**

Ky akord do të ratifikohet në afatin më të shkurtër dhe do të hyjë në fuqi ditën e shkëmbimit të dokumenteve të ratifikimit.

Ky akord lidhet për një afat pesëvjeçar, që nga data e hyrjes së tij në fuqi. Validiteti i tij mund të zgjatet dy herë, për një periudhë tjetër prej pesë vjetësh, në qoftë se nuk është denoncuar gjashtë muaj përpara mbarimit të afatit aktual.

Shkëmbimi i dokumenteve të ratifikimit do të bëhet në Varshavë.

Bërë në Tiranë, më 2 dhjetor 1950, në dy ekzemplarë, në gjuhën shqipe dhe në gjuhën polake; të dy tekstet janë autentike.

Dokumenti u nënshkrua dhe u vulos nga të dy palët.

*Tabela paraqet 11 artikujt e marrëveshjes kulturore shqiptaro-polake të 2 nëntorit 1950.<sup>81</sup>*

**Veprimtaria kulturore mes Shqipërisë dhe Polonisë gjatë vitit 1951**

Dokumenti i vitit 1951, i lidhur me zbatimin e marrëveshjes së bashkëpunimit kulturor midis Shqipërisë dhe Polonisë, përbën një plan kuadër me qëllim forcimin e lidhjeve ndërkulturore midis dy vendeve, përmes një sërë aktiviteteve kulturore, arsimore dhe artistike. Propozimet e parashtruara në këtë dokument synojnë të promovojnë mirëkuptimin e ndërsjellë dhe zhvillimin e projekteve të përbashkëta.<sup>82</sup>

**Elementet kryesore të marrëveshjes përfshijnë:**

**1. Publikime:** Plani parashikon publikime të përbashkëta të veprave letrare dhe shkencore, përkthime nga polonishtja në shqip dhe anasjelltas, si dhe promovimin e gjuhës polake në Shqipëri. Veç kësaj, parashihen përkthime në gjuhë të tjera, si rusishtja dhe frëngjishtja, për të rritur shtrirjen ndërkombëtare të materialeve kulturore.

**2. Shkëmbimi i artistëve dhe shkencëtarëve:** Dokumenti thekson ftesën e artistëve, gazetarëve dhe shkencëtarëve nga të dy vendet, me qëllim zhvillimin e projekteve të përbashkëta artistike dhe kërkimore, si dhe nxitjen e mirëkuptimit kulturor ndërkombëtar.

<sup>81</sup> AMSZ, Dep. Departament I za lata 1949 – 1960 (państwa socjalistyczne – bez NRD), sygn. Z – 7 W – 19 T – 167, Polska – albańska umowa kulturalna..., dok.i.cit, fl.7-9; AMPJ, V. 1950, D.98, Mbi nënshkrimin..., dok.i.cit, fl.9/1, 9/2.

<sup>82</sup> AMSZ, Dep. Departament I za lata 1949 – 1960 (państwa socjalistyczne – bez NRD), sygn. Z – 7 W – 19 T – 167, Polska – albańska umowa kulturalna..., dok.i.cit, fl.14.

**3. Arsimi dhe bursat:** Marrëveshja përfshin shkëmbimin e studentëve dhe mbështetjen për studentët shqiptarë në Poloni, duke përfshirë programe bursash dhe aktivitete për promovimin e gjuhës polake në Shqipëri. Këto iniciativa synojnë zhvillimin e kompetencave gjuhësore dhe kulturore të pjesëmarrësve.

**4. Promovimi i kinematografisë:** Plani parashikon prodhimin e përbashkët të filmave dhe përkthimin e dokumentarëve në shqip, me qëllim rritjen e disponueshmërisë së prodhimeve filmike polake në Shqipëri dhe njohjen e kulturës vizuale të vendit fqinj.

**5. Muzikë dhe art:** Aktivitetet përfshijnë popullarizimin e muzikës klasike dhe popullore, si dhe organizimin e koncerteve. Dokumenti thekson rëndësinë e mbështetjes së artistëve shqiptarë në krijimtarinë dhe prezantimin e tyre, duke kontribuar në zhvillimin e jetës kulturore lokale.

**6. Arsimi për të rritur:** Marrëveshja përfshin gjithashtu programe arsimit për të rritur, me qëllim luftimin e analfabetizmit dhe përmirësimin e cilësisë së arsimit në Shqipëri.<sup>83</sup>

Në përgjithësi, dokumenti i vitit 1951 tregon një qasje të strukturuar dhe të shumanshme ndaj bashkëpunimit kulturor midis Shqipërisë dhe Polonisë. Ai jo vetëm që synon forcimin e lidhjeve ndërkulturore dhe artistike, por gjithashtu kontribuon në afirmimin e pozitës së të dy vendeve brenda kontekstit më të gjerë të Luftës së Ftohtë.

Gjatë vitit 1951 u zhvilluan bisedime midis përfaqësuesve të palës polake dhe asaj shqiptare, ku disa prej tyre trajtuan edhe çështje kulturore. Një nga takimet kyçe ishte ai i datës 22 mars 1951<sup>84</sup>, ku Feliksa Koniecznyńska<sup>85</sup> përfaqësonte palën polake, ndërsa Abdyl Ulqinaku palën shqiptare. Gjatë këtij takimi, Ulqinaku informoi përfaqësuesit polakë mbi interesin e autoriteteve shqiptare për dokumente historike të ruajtura në arkiva, biblioteka dhe muze.<sup>86</sup> Ulqinaku gjithashtu pyeti nëse Polonia kishte gjetur ndonjë gjurmë

<sup>83</sup> AMSZ, Dep. Departament I za lata 1949 – 1960 (państwa socjalistyczne – bez NRD), sygn. Z – 7 W – 19 T – 167, Polska – albańska umowa kulturalna..., dok.i.cit, fl.14.

<sup>84</sup> AMSZ, Dep. Departament I za lata 1949 – 1960 (państwa socjalistyczne – bez NRD), sygn. Z – 7 W – 17 T – 148, Notatki z rozmów prowadzonych przez polskich dyplomatów..., dok.i.cit, fl.25.

<sup>85</sup> Më 1 shkurt 1949, Feliksa Koniecznyńska, e cila më parë shërbente si zëvendësreferendare në Ministrinë e Punëve të Jashtme, u emërua referendare.

<sup>86</sup> AMSZ, Dep. Departament I za lata 1949 – 1960 (państwa socjalistyczne – bez NRD), sygn. Z – 7 W – 17 T – 148, Notatki z rozmów prowadzonych przez polskich dyplomatów..., dok.i.cit, fl.25.

të dy qytetarëve shqiptarë që ishin zhdukur në Gjermani gjatë Luftës së Dytë Botërore, duke treguar një interes për të marrë informacion mbi personat që vdiqën ose u zhdukën gjatë konfliktit. Për më tepër, ai informoi palën polake mbi mbërritjen e planifikuar të 47 punëtorëve shqiptarë në Poloni për trajnim, duke reflektuar kështu bashkëpunimin në rritje midis dy vendeve në fushën e shkëmbimit të punës dhe trajnimit profesional, i cili kishte për qëllim të kontribuonte në rindërtimin dhe modernizimin e të dy vendeve pas Luftës së Dytë Botërore.<sup>87</sup>

Në një raport të datës 25 mars 1951, Ministri i Kulturës, Kahraman Ylli, vuri në dukje se shumica e studentëve shqiptarë që ndodheshin jashtë vendit, pas Bashkimit Sovjetik, zgjodhën Poloninë, jo për arsye materiale ose për shkak të kujdesit që iu ofrua atyre, por kryesisht për shkak të rezultateve të arritura në mësim dhe të atmosferës pozitive që gjetën tek të rinjtë polakë.<sup>88</sup>

Në vitet 1951- 1952, bashkëpunimi kulturor midis Polonisë dhe Shqipërisë shënoi një rritje të konsiderueshme, veçanërisht në fushën e arsimit. Si pjesë e zbatimit të Marrëveshjes për Bashkëpunim Kulturor, pala polake siguroi 113 tekste shkollore, kurrikula, revista pedagogjike dhe gjashtë vepra letrare për fëmijë të përkthyer në gjuhën shqipe. Ky kontribut jo vetëm që forconte lidhjet kulturore ndërmjet dy vendeve, por shërbente gjithashtu si mjet për transmetimin e përvojës dhe vlerave të sistemit arsimor socialist polak në Shqipëri.

Komiteti lokal për Bashkëpunim Kulturor ofroi materiale të ndryshme të rëndësishme për promovimin e kulturës polake në Shqipëri, përfshirë dy tregime të shkurtra nga Stefan Żeromski dhe Orkan në gjuhën ruse për përkthim në shqip, tri vëllime me ilustrime të kostumeve popullore polake, si dhe një set të plotë materialesh mbi arsimin e lartë artistik në Poloni, në gjuhën ruse. Gjithashtu, u dhanë libra mbi letërsinë dhe muzikën polake, përveç biografive të shkrimtarëve dhe studiuesve të njohur polakë.<sup>89</sup>

Me këto burime, Komiteti organizoi një ekspozitë udhëtuese për studentët shqiptarë, e cila kishte për qëllim njohjen e tyre me zhvillimin e shkencës, letërsisë, si dhe arsimit të mesëm dhe të lartë në Poloni. Për më tepër, u planifikua realizimi i ekspozitave të vogla në rreth 30 qytete dhe fshatra shqiptare, të bazuara në këto materiale, me qëllim promovimin e njohurive

---

<sup>87</sup> Po aty, fl.25-26.

<sup>88</sup> AMSZ, Dep. Departament I za lata 1949 – 1960 (państwa socjalistyczne bez NRD), sygn. Z – 7 W – 18 T – 158, Raporty polityczne Rzeczpospolitej..., dok.i.cit, fl.134.

<sup>89</sup> Po aty, fl.166.

mbi Planin Gjashtëvjeçar për Ndërtimin e Themeleve të Socializmit në Poloni.<sup>90</sup>

Në kuadër të përpjekjeve për intensifikimin e marrëdhënieve dypalëshe dhe për promovimin e imazhit të Republikës Popullore të Polonisë në opinionin publik shqiptar, gjatë periudhës së raportimit pala polake dorëzoi pranë Departamentit të Informacionit për Shtyp të Ministrisë së Punëve të Jashtme një sërë materialesh të hartuara posaçërisht për botim në shtypin shqiptar. Këto materiale, me karakter propagandistik, synonin të pasqyronin përparimin e Polonisë në fusha të ndryshme të jetës shoqërore, ekonomike dhe ushtarake, duke ndërtuar një imazh pozitiv të modelit socialist polak.<sup>91</sup>

Artikujt e përgatitur trajtonin tema të tilla si:

- Sigurimet Shoqërore në Republikën Popullore të Polonisë
- Kujdesi Shëndetësor në Republikën Popullore të Polonisë
- Kujdesi për Nënë dhe Fëmijën në Republikën Popullore të Polonisë
- Ndërtimi i Komplekseve të Banimit në Poloni
- Traditat Progresive të Ushtrisë Polake
- Ekspozita e Industrisë dhe Artizanatit në Shkallë të Vogël në Poznań<sup>92</sup>

Ky aktivitet propagandistik kishte për qëllim jo vetëm krijimin e një perceptimi të favorshëm mbi modelin socialist polak, por edhe kontributin në ndërtimin e një narrative të unifikuar ideologjike brenda kampit lindor, duke reflektuar përpjekjet e vendeve socialiste për harmonizimin e diskurseve politike e kulturore në kontekstin e Luftës së Ftohtë.

Gjatë periudhës së raportimit, Polonia vuri në dispozicion të shtypit shqiptar një sasi të konsiderueshme materialesh, të cilat përfshinin gjithsej 31 buletine, periodikë, ilustrime dhe botime të ndryshme me përmbajtje politike, sociale dhe kulturore. Ky angazhim përbën një dëshmi të qartë të përpjekjeve të vazhdueshme për forcimin e dialogut dhe bashkëpunimit kulturor ndërmjet dy vendeve. Në fushën e shkëmbimeve arsimore vërehet një zhvillim progresiv: gjatë vitit akademik 1950-1951 numri i studentëve shqiptarë në universitetet polake arriti në 77, ndërsa në vitin 1951-1952 u rrit në 87, duke shënuar një rritje prej rreth 13%.

<sup>90</sup> Po aty, fl.166.

<sup>91</sup> AMSZ, Dep. Departament I za lata 1949 – 1960 (państwa socjalistyczne bez NRD), sygn. Z – 7 W – 18 T – 158, Raporty polityczne Rzeczpospolitej..., dok.i.cit, fl.167.

<sup>92</sup> AMSZ, Dep. Departament I za lata 1949 – 1960 (państwa socjalistyczne bez NRD), sygn. Z – 7 W – 18 T – 158, Raporty polityczne Rzeczpospolitej..., dok.i.cit, fl.167.

Ky trend pasqyron një interes në rritje nga pala shqiptare dhe tregon për një konsolidim gradual të marrëdhënieve arsimore midis dy vendeve socialiste.<sup>93</sup>

Megjithatë, pavarësisht rritjes së vëllimit të materialeve të shpërndara dhe intensifikimit të kontakteve, Sekretari i Përgjithshëm i Komitetit Lokal për Bashkëpunim Kulturor Jashtë Vendlit ka theksuar se efektiviteti i përpjekjeve të ndërmarra nuk ishte proporcional me rezultatet e arritura gjatë kësaj periudhe. Ky hendek reflekton disa problematika themelore në menaxhimin dhe koordinimin e bashkëpunimit kulturor. Së pari, mungesa e personelit të kualifikuar dhe me përvojë në Shqipëri përbënte një pengesë të rëndësishme për organizimin dhe realizimin e aktiviteteve me standard të lartë profesional. Së dyti, kufizimet teknike të disponueshme ndikonin negativisht në efektivitetin e promovimit dhe shpërndarjes së materialeve kulturore. Së fundi, shpërndarja e burimeve dhe përpjekjeve të Shqipërisë në kuadër të marrëdhënieve kulturore me vende të tjera socialiste – si Bashkimi Sovjetik, Hungaria, Rumania dhe Bullgaria – e pengonte përqendrimin dhe konsolidimin e plotë të potencialit kulturor në marrëdhëniet me Poloninë.<sup>94</sup>

---

<sup>93</sup> Po aty, fl.167.

<sup>94</sup> Po aty, fl.167.

## Bibliografi:

### Burime arkivore:

#### Archiwum Ministerstwa Spraw Zagranicznych (AMSZ):

- Departament: Protokół Dyplomatyczny z lat 1945–1963, sygn. Z–16 W–3 T–50, Protokół Dyplomatyczny – Poseł Albanii w Moskwie Mihal Prifti proponowany równocześnie na Posła Albanii w Warszawie: Listy uwierzytelniające, korespondencja, notatki, 1949–1951, Daty Skrajne: 1949 – 1951, Państwo: Albania – Ludowa Republika Albanii, Polska – PRL, Region Świata: Europa Południowa, Europa Wschodnia.
- Departament: Departament I za lata 1949 – 1960 (państwa socjalistyczne bez NRD), sygn. Z–7 W–17 T–148, Notatki z rozmów prowadzonych przez polskich dyplomatów z dyplomatami albańskimi akredytowanymi w Warszawie, Daty Skrajne: 1949-1958, Państwo: Albania, Polska – PRL, Region Świata: Bałkany, Europa Środkowa.
- Departament: Protokół Dyplomatyczny z lat 1945 – 1963, sygn. Z – 16 W – 3 T – 46, Protokół Dyplomatyczny – Utworzenie Poselstwa Polski w Tiranie. Bolesław Jeleń Chargé D’Affaires en pied, Listy wprowadzające, korespondencja, Daty Skrajne: 1949 – 1960, Państwo: Albania – Ludowa Republika Albanii, Polska – PRL, Region Świata: Europa Południowa, Europa Wschodnia.
- Departament: Departament I za lata 1949 – 1960 (państwa socjalistyczne bez NRD), sygn. Z – 7, W – 17, T – 147, Notatki z rozmów polskich dyplomatów w Tiranie, Daty Skrajne: 1949 – 1960, Państwo: Albania, Polska – PRL, Region Świata: Bałkany, Europa Środkowa.
- Departament: Departament I za lata 1949 – 1960 (państwa socjalistyczne bez NRD), sygn. Z – 7 W – 18 T – 158, Raporty polityczne Rzeczypospolitej Polskiej w Tiranie, Daty Skrajne: 1949 – 1951, Państwo: Albania – Polska – PRL, Region Świata: Bałkany, Europa Środkowa.
- Departament: Protokół Dyplomatyczny z lat 1945 – 1963, sygn. Z – 16 W – 3 T – 44, Protokół Dyplomatyczny - Ordery i odznaczenia; odznaczenia albańskie dla obywateli polskich nadane przez Prezydium Zgromadzenia Ludowego Albanii członkom polskiej delegacji wojskowej na uroczystości związane z obchodami Święta Armii Albańskiej; korespondencja, zarządzenia, notatki, Daty Skrajne: 1950 – 1951, Państwo: Albania – Polska – PRL, Ludowa Republika Albanii, Region Świata: Europa Południowa, Europa Wschodnia.
- Departament: Departament I za lata 1949 – 1960 (państwa socjalistyczne – bez NRD), sygn. Z – 7 W – 19 T – 167, Polska – albańska umowa kulturalna, dokumenty ratyfikacyjne, roczne plany współpracy kulturalnej, materiały do

negocjaci, interwencje, uwagi do projektów planów, ocena ich realizacji, protokoły z posiedzeń Komisji Mieszanej, Daty Skrajne: 1951 – 1960, Państwa: Albania, Polska, Polska PRL, Region Świata: Bałkany, Europa Południowa, Europa Środkowa.

**Arkivi i Ministrisë së Punëve të Jashtme (më tej: AMPJ):**

- V.1949, D.62, Shkëmbime me Poloninë në fushat shkencore, shoqërore e sportive.
- V. 1950, D. 91, Mbi dekorimin e disa shtetasve polakë.
- V. 1950, D.93, Çështje të veçanta ekonomike me Poloninë: - Furnizimi i gjeneratorëve diesel nga Polonia - Mbi blerje filmash në Poloni.
- V.1950, D.98, Mbi nënëshkrimin e një marrëveshjeje kulturore me Poloninë dhe aktivitete kulturore konkrete.
- V. 1950, D.99, Mbi veprimtarinë e publicistëve dhe gazetarëve polakë në drejtim të vendit tonë.
- V.1950, D.101, Dokumente mbi ftesat në kongrese dhe aktivitete të tjera shkencore, kulturore e sportive.

**Literatura:**

- Zygmunt Kaczmarek, “Stosunki między Polską a Albanią,” në *Stosunki Polski z innymi państwami socjalistycznymi*, red. Czesław Mojsewicz (Warszawa: Państwowe Wydawnictwo Naukowe, 1973).
- Shtypi
- Dziennik Urzędowy: Ministerstwa Spraw Zagranicznych, Warszawa 31 marca 1949 r., Nr.2.
- Trybuna Ludu, Organ KC Polskiej Zjednoczonej Partii Robotniczej, Warszawa – Środa, 26 lipca 1950 r. Nr. 203 (575) Rok III.
- Trybuna Ludu, Organ KC Polskiej Zjednoczonej Partii Robotniczej, Warszawa – Środa, 26 lipca 1950 r. Nr. 202 (574) Rok III.
- Dziennik Zachodni, Katowice dnia 26 lipca 1950 roku, Nr.169 (1722), AB.
- Trybuna Ludu, Organ KC Polskiej Zjednoczonej Partii Robotniczej, Warszawa – Czwartek, 27 lipca 1950 r. Nr. 204 (575) Rok III.
- Dziennik Zachodni, Czytelnik, Środa 6 grudnia 1950 r., Nr.336 (2085) – Rok VI.

**Donika AVDULLI**

The Institute of History “Ali Hadri”

Email: d.avdulli@uw.edu.pl

ORCID: 0009-0006-9400-7191

KUD: 327(496.5:438)“1949/1951”(05)

**SUMMARY****ALBANIA – POLAND CULTURAL RELATIONS (1949–1951)  
ACCORDING TO ALBANIAN - POLISH DIPLOMATIC  
DOCUMENTS**

The study of Albanian - Polish cultural relations during the years 1949 - 1951, based on archival documents, highlights a period laden with international tensions, but at the same time characterized by intensive efforts to consolidate solidarity within the socialist camp. Albanian–Polish diplomacy should not be seen merely as a usual bilateral process, but as an important link in the broader network of Eastern European relations, guided by Stalinist politics and ideology. On the diplomatic level, the appointment of Mihal Prifti in Warsaw and of Bolesław Jeleń in Tirana were not merely ordinary acts of diplomatic staff rotation. They embodied the necessity of establishing an organized political, economic, and cultural cooperation, which served not only Albania and Poland, but also the consolidation of the structure of socialist alliances. The partisan experience of the Albanian diplomats and the political background of the Polish representatives testify to the ideological nature of their selection. In this sense, the representatives were not seen only as actors of foreign policy, but also as bearers of a political mission to convey the image of a strong and unbreakable alliance within the socialist camp.

Of particular importance is also the fact that cultural relations were not merely a secondary field, but an active instrument of foreign policy. Invitations to writers’ congresses, commemorations of the victims of Nazism, and sporting events such as the “Tour de Pologne” served as mechanisms for building bridges of communication and producing a kind of popular diplomacy. However, the limited participation of the Albanian side in certain cultural activities testifies to increased caution from Tirana, which, after the break with Yugoslavia (1948), was still in the process of strategic repositioning and feared any undesirable influence.

Compared to Albania's relations with other socialist countries, its relations with Poland present interesting similarities and differences. With Czechoslovakia, for example, Albania developed a more pronounced economic and technical-industrial relationship, especially after 1950, including the sending of Albanian specialists and students to Prague. Meanwhile, with Hungary, cultural relations had a stronger educational and propagandistic dimension, connected with translations and the publication of political literature. In this context, Poland held a special place because of its long intellectual tradition and its engagement in the field of culture and sport, which gave its relations with Albania a more vivid social profile.

Another important comparative element is the role of the supporting staff in the Albanian legations abroad. In Warsaw, the presence of figures such as Llambi Dishnica or Abdyl Ulqinaku, as well as the involvement of diplomats' wives in social activities, testifies to an integrated concept of diplomacy, which was not limited only to political relations but also to the creation of a favorable cultural environment. A similar phenomenon is observed also in Albanian - Bulgarian relations, where the diplomats' spouses are often mentioned in archival reports as active participants in the social life of the missions.

Finally, it should be emphasized that Albanian-Polish cultural relations in the period 1949 - 1951 were part of a broader project of cultural and ideological integration of the countries of the socialist camp. In this project, culture and diplomacy were two inseparable instruments: culture served to build popular solidarity and the external image of friendship, while high-level diplomacy maintained political coordination at the state level. In this way, relations with Poland were not isolated, but part of a broader model in which each socialist country had a specific role in consolidating the "common front" against the capitalist West.

In conclusion, Albanian - Polish relations during the years 1949 – 1951 present a clear illustration of the intertwining of foreign policy with cultural diplomacy in the Cold War era. They were simultaneously an expression of ideological solidarity and an instrument of Tirana's foreign policy, which aimed to assert its identity within the socialist camp. Comparisons with the relations that Albania developed with Czechoslovakia, Hungary, and Bulgaria show that, although the general model of cultural diplomacy was the same, relations with Poland stood out for their cultural dynamism and the effort to create an image of broad social cooperation. Thus, this case study allows us to gain a deeper understanding of how even a small country like Albania, through diplomatic and cultural channels, contributed to the larger architecture of postwar socialist international relations.